



ALBANIAN UNIVERSITY  
*UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME*

# STATUTI

Nr 302 Prot  
Dt 20.07.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN  
DREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARDIZIMIT DHE HARMONIZIMIT TË KUADRIT  
RREGULLATOR

Nr. 3531 Prot.  
3

Tiranë, më 18.7. 2023

Lënda: Dërgohet urdhri për njohje dhe zbatim

UNIVERSITETIT "ALBANIAN UNIVERSITY"

Adresa: Bulevardi "Zogu I", 1001, Tiranë

Bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin nr. 380, datë 14.7.2023, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për miratimin e Statutit të Universitetit "Albanian University".

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 3531/2 Prot.

Tiranë, më 14.7.2023

URDHËR

Nr. 380, datë 14.7.2023

PËR

MIRATIMIN E STATUTIT TË UNIVERSITETIT “ALBANIAN UNIVERSITY”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e statutit të Universitetit “Albanian University”, bazuar në propozimin e dhënë në vendimin e Senatit Akademik nr. 8, datë 10.05.2023 dhe të Bordit të Administrimit nr. 7, datë 10.05.2022, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri (49 faqe).
2. Të gjitha rregulloret dhe aktet e tjera të Universitetit “Albanian University”, të miratohen në zbatim të këtij Statuti dhe kuadrit ligjor në fuqi.
3. Statuti i Universitetit “Albanian University”, hyn në fuqi pas hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
4. Statuti ekzistues i Universitetit “Albanian University”, shfuqizohet.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Universiteti “Albanian University”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

EVIS KUSHI





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

### KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1

##### Baza ligjore

Veprimtaria e Albanian University (këtu e në vazhdim AU) bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (nenin 57, pika 6,7), në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" (këtu e në vazhdim Ligji Nr. 80/2015), Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, në Ligjin "Për shoqëritë tregtare", në këtë Statut, si dhe në rregulloret e tjera të AU-së.

#### Neni 2

##### Statusi juridik

1. AU-ja është person juridik, i organizuar si institucion jopublik i arsimit të lartë, me statusin e Universitetit, që financohet nga burimet e veta të brendshme dhe burime të tjera të ligjshme.
2. AU-ja e ka selinë e tij qendrore në Tiranë.
3. AU-ja është vijues i Universitetit UFO (UFO University), themeluar me Vendimin Nr. 197, datë 10.04.2004 të Këshillit të Ministrave dhe me emërtim të ndryshuar me Vendimin Nr. 603, datë 24.03.2011 të Këshillit të Ministrave.
4. AU-ja ka stemën dhe vulën e tij, të cilat i bashkëngjiten si Aneks 1 këtij Statuti.

#### Neni 3

##### Misioni i AU

Misioni i AU-së është:

- a. të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me në fokus studentin;
- b. të ofrojë programe studimi me karakter profesional dhe programe të studimeve në të tre ciklet e studimit;
- c. të zhvillojë veprimtari kërkimore-shkencore dhe veprimtari krijuese në të gjitha fushat që mbulon dhe të përgatisë specialistë dhe shkencëtarë të rinj;
- d. të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimit i lartë gjatë gjithë jetës;
- e. të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;
- f. të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri bashkëkohore;
- g. të ofrojë shërbime, brenda misionit të tij si një institucion i arsimit të lartë;
- h. të mbështesë dhe realizojë promovimin e personelit akademik, duke i garantuar mundësi të barabartë për të përfituar nga financimet për kërkim shkencor.



*[Handwritten signature]*



## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

### Neni 4

#### Vizioni

AU-ja synon të mbetet model i arsimit të lartë, i karakterizuar nga përgatitje rigorozë akademike dhe kërkim i thelluar shkencor, si një institucion i arsimit të lartë i zgjedhjes së parë për studentët e angazhuar në transformimin e jetës së tyre dhe të shoqërisë.

### Neni 5

#### Standardet bashkëkohore

Arsimi i lartë në AU zhvillohet në përputhje me objektivat e Kartës së Bolonjës, duke respektuar Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe standardet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (këtu e në vazhdim HEAL), si dhe duke nxitur dhe mbështetur kërkimin shkencor dhe lirinë e tij.

### Neni 6

#### Parimet

1. Parimet nga të cilat udhëhiqet AU-ja janë:
  - a) Liria akademike dhe e kërkimit shkencor;
  - b) Autonomia institucionale;
  - c) Nxitja e kreativitetit/inovacionit;
  - d) Integriteti;
  - e) Ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave personale;
  - f) Respekti reciprok;
  - g) Puna në grup;
  - h) Profesionalizmi;
  - i) Meritokracia;
  - j) Drejtësia dhe mosdiskriminimi;
  - k) Laiciteti.

### Neni 7

#### Liria akademike

1. Liria akademike qëndron në respektimin e shumëllojshmërisë së mendimeve, të ideve e metodave, dhe në garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies e të kërkimit shkencor, si dhe të shërbimeve në përputhje me standardet e HEAL.
2. Liria akademike në AU garantohet nëpërmjet së drejtës:
  - a. për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, ato kërkimore-shkencore, të inovacionit dhe veprimtaritë krijuese;
  - b. për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore;
  - c. për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

### Neni 8

#### Autonomia institucionale

1. AU-ja është institucion i arsimit të lartë që gëzon autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit. Në kuadrin e kësaj autonomie, AU-së i njihet e drejta e:
  - a. vetëqeverisjes, zgjedhjes së organeve drejtuese, përzgjedhjes së personelit të tij dhe caktimit e pagave të tyre, organizimit të strukturave të brendshme dhe veprimtarisë së tyre nëpërmjet këtij Statuti dhe rregulloreve të hartuara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
  - b. caktimit të kriterëve të pranimit të studentëve në programet e studimeve;
  - c. vendosjes së marrëdhënieve dhe lidhjes së marrëveshjeve me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, për shkëmbim përvoja, bashkëpunim në mësimdhënie, në kërkimin shkencor, për kualifikimin e personelit dhe veprimtari të tjera, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e AU-së;
  - d. krijimit të të ardhurave të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, nga veprimtaritë artistike dhe sportive, dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi;
  - e. përfitimit të fondeve nga shteti dhe organizma të tjerë;
  - f. caktimit të rregullave të brendshme të financimit, shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit;
  - g. përcaktimit të tarifave të studimit;
  - h. administrimit të pasurive të luajshme dhe të paluajshme që AU-ja zotëron ligjërisht, në përputhje me misionin e tij;
  - i. aktivitetit botues në përputhje me nevojat e procesit mësimor e të kërkimit shkencor;
  - j. konkurrimit me projekte me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar për financimin e kërkimit shkencor.

### Neni 9

#### Paprekshmëria territoriale

1. Të gjitha mjediset ku ushtron veprimtarinë e saj AU-ja janë të pacënueshme nga çdo ndërhyrje përveç rasteve të parashikuara në ligj dhe për një interes legjitim. Cënimi i paprekshmërisë territoriale të AU-së, ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.
2. Ndërhyrja e organeve të rendit publik në mjediset e AU-së, bëhet me kërkesën ose lejen e titullarit të institucionit (Rektorit dhe në mungesë të tij nga personat e autorizuar për të ushtruar kompetencat e tij).
3. Ndërhyrja e forcave të rendit lejohet pa lejen e rektorit vetëm në kushtet e flagrancës sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, në rastet e fatkeqësive natyrore apo gjendjes së jashtëzakonshme dhe kur një gjë e tillë është e nevojshme dhe e diktuar nga këto gjendje, apo në rastet e kontrollit të miratuara rregullisht nga gjykata sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

### KREU II

### ORGANIZIMI I UNIVERSITETIT DHE STRUKTURAT PËRBËRËSE

#### Neni 10

##### Parim i përgjithshëm

Qeverisja e Albanian University bazohet në bashkëpunimin e organeve drejtuese dhe autoriteteve drejtuese në nivel universiteti, fakulteti, departamenti dhe njësive të tjera akademike dhe administrative, si dhe në ushtrimin e pavarur të kompetencave të organeve dhe autoriteteve sipas legjislacionit në fuqi dhe këtij Statuti dhe akteve të tjera në bazë dhe zbatim të tij.

#### Neni 11

##### Struktura organizative

Struktura organizative e AU-së, si një IAL jopublike me statusin e Universitetit është miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Rregullimi i brendshëm i AU-së bëhet me anë të këtij Statuti, si dhe të rregulloreve të tjera që dalin në bazë dhe në zbatim të tij.

1. Struktura organizative e AU-së është e pasqyruar në organigramën e universitetit, dokument i cili i bashkëngjitet si Aneks 2 këtij Statuti.
2. Në rastet kur Organigrama do të ndryshohet për shkak të riorganizimit të institucionit (hapjes, organizimit), ky ndryshim do të pasqyrohet në Statut, ndryshimet e të cilit do të miratohen referuar parashikimit të Nenit 33 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

#### Neni 12

##### Organet dhe autoritetet drejtuese

1. Organi më i lartë drejtues akademik i AU-së është Senati Akademik.
2. Organe të tjera akademike janë Asambleja e Personelit Akademik dhe Komisionet e Përhershme.
3. Organe kolegjinale të tjera janë Rektorati, Dekanati, Këshilli i Etikës.
4. Autoritetet drejtuese akademike janë: Rektori, Dekani, Drejtuesi i njësive të bazës.
5. Organi më i lartë drejtues administrativ është Bordi i Administrimit.
6. Autoritetet drejtuese administrative janë: Administratori i institucionit dhe Administratorët e njësive kryesore.
7. Strukturat e tjera të universitetit renditen në formë njësish, në varësi të organeve më të larta drejtuese. AU-ja ka të drejtë të përfshijë në strukturën e tij autoritete dhe organe të tjera, në përputhje me misionin dhe veprimtarinë e tij, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

### PJESA E PARË ORGANIZIMI AKADEMIK

#### Neni 13

#### Senati Akademik

1. Senati Akademik është organi më i lartë kolegjal drejtues akademik, në nivel universiteti në AU dhe është përgjegjës për përbushjen e misionit të tij.
2. Senati ka 19 (nëntëmbëdhjetë) anëtarë, me përbërjen si vijon :
  - a. përfaqësues të personelit akademik: 18 (tetëmbëdhjetë) anëtarë;
  - b. përfaqësues të studentëve: 1 (një) anëtar, Kryetari i Këshillit Studentor të AU-së.
3. Çdo fakultet përfaqësohet në Senat, nga jo më pak se 25% e përbërjes së tij. Kjo përqindje përfaqësimi ndryshon në përpjestim të drejtë me ndryshimin e numrit të fakulteteve.
4. Anëtarët e Senatit akademik në AU zgjidhen nga Asambletë e Personelit Akademik të Fakulteteve. Ata duhet të jenë anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë në AU dhe zgjidhen nëpërmjet vetëkandidimit të tyre.
5. Anëtarët e Senatit në AU, janë me titullin akademik “Profesor”, “Profesor i asociuar” ose ata mund të mbajnë edhe gradën shkencore “Doktor” të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së; në mungesë të këtyre të fundit, anëtarët e Senatit Akademik në AU, mund të mbajnë edhe gradën shkencore “Doktor” të fituar në universitetet shqiptare.
6. Mandati i anëtarit të Senatit është me kohëzgjatje 4-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje i cili fillon ditën e shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve dhe mbaron në të njëjtën ditë të vitit të katërt pas zgjedhjes së tij.
7. Mandati i anëtarit të Senatit mbaron përpara këtij afati:
  - a. me dhënien e dorëheqjes;
  - b. me largimin nga AU-ja;
  - c. në raste paaftësie fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
  - d. kur anëtari mungon pa shkaqe të arsyeshme së paku 3 mbledhje gjatë një viti akademik;
  - e. në rastet kur ndaj një anëtari jepet masë disiplinore për shkelje të rëndë të etikës. Pezullimi në këtë rast zgjat sa kohë zgjat masa kur ajo jepet me afat ose një vit kur ajo nuk jepet me afat.
  - f. kur dënohet me një vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, e cila cënon rëndë figurën morale dhe integritetin e të qenit “personel akademik” apo për cdo vepër tjetër penale, kur masa dhe lloji i dënimit që jepet e bën të pamundur ushtrimin e funksionit të anëtarit të Senatit.
8. Mandati i anëtarit të Senatit pezullohet kur:
  - a. Ndaj anëtarit fillohet një procedim penal dhe ndaj tij jepet masë sigurimi personale që pamundëson ushtrimin e funksionit sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale dhe legjislacionin tjetër në fuqi dhe në rastet e tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
  - b. Në çdo rast tjetër të parashikuar në ligj.
9. Pezullimi i mandatit ose mbarimi i parakohshëm i tij, deklarohet me efekt të menjëhershëm me vendim të Senatit në mbledhjen më të parë të tij. Procesi i deklarimit të pezullimit dhe të





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

mbarimit të parakohshëm të mandatit duhet të respektojë të drejtën për një proces të rregullt të anëtarit, subjekt i këtij procedimi.

10. Anëtarët e Senatit Akademik vazhdojnë ushtrimin e mandatit deri në zëvendësimin e rregullt të tyre, në rast të pamundësisë objektive për organizimin e zgjedhjeve. Kur vazhdimi i mandatit nuk është i mundur, organizohen zgjedhje të parakohshme për një mandat sa pjesa e mbetur e mandatit të Senatit. Zëvendësimi i vendeve të lira bëhet vetëm me përfaqësues të së njëjtës kategori dhe të njëjtit fakultet të cilit i përkiste anëtari, vendi i të cilit ka mbetur i lirë.
11. Çdo anëtar i Senatit ka detyrimin të njoftojë me shkrim pamundësinë për të marrë pjesë dhe sipas rastit e shoqëron njoftimin me dokumente provuese. Në rast pamundësie për të njoftuar paraprakisht, anëtari ka detyrimin ta parashtrojë me shkrim shkaqet e mungesës dhe pamundësisë së njoftimit sa më shpejt që të jetë e mundur.
12. Senati Akademik kryen këto funksione kryesore:
  - a. përcakton politikat e zhvillimit të AU-së;
  - b. programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor, si dhe vlerëson efikasitetin e tyre;
  - c. garanton autonominë e AU-së, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve;
  - d. garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në AU dhe krijon mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik;
  - e. miraton vendosjen e marrëdhënieve në nivel kombëtar e ndërkombëtar me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare të propozuara nga fakultetet, në funksion të zhvillimit institucional dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të AU-së;
  - f. miraton Statutin e AU-së me 2/3 (dy të tretat) e votave të anëtarëve të tij, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit;
  - g. miraton me shumicë të thjeshtë të votave të të gjithë anëtarëve të pranishëm Rregulloren e Përgjithshme dhe rregulloret e tjera të universitetit;
  - h. harton strukturën e përgjithshme të AU-së dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit akademik dhe administrativ në të gjitha nivelet;
  - i. propozon për miratim në Bordin e Administrimit planin strategjik të zhvillimit të AU-së, të hartuar nga Rektorati;
  - j. propozon për miratim në Bordin e Administrimit, projektbuxhetin vjetor dhe atë afatmesëm 3-vjeçar të AU-së, të hartuar nga Administratori i Përgjithshëm;
  - k. propozon dhe miraton Komisionet e Përhershme në AU;
  - l. miraton hapjen e programeve të reja të studimit, ndryshimet dhe riorganizimet në programet ekzistuese, si dhe mbylljen e tyre. Ndryshimi/riorganizimi i programeve të studimit apo mbyllja e tyre miratohet, pasi është marrë vlerësimi paraprak nga Bordi i Administrimit;
  - m. propozon në Bordin e Administrimit mbylljen dhe riorganizimin e universitetit, si dhe ndarjen ose bashkimin e tij me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
  - n. miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të AU-së apo degëve të tilla, për bazën e propozimeve të fakulteteve dhe departamenteve, pasi ka marrë vlerësimin paraprak nga Bordi i Administrimit;





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

- o. miraton në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të AU-së, të hartuar nga Rektorati dhe ia përcjell atë ministrisë përgjegjëse për arsimin, konform legjislacionit në fuqi;
  - p. zgjedh Rektorin e AU-së, mbi bazën e të paktën 2 (dy) kandidaturave alternative, të cilat paraqiten nga Administratori i shoqërisë tregtare, nga radhët e personelit akademik ekzistues ose/dhe jashtë tij;
  - q. me propozim të Rektorit, emëron Dekanin e fakultetit, mbi bazë të një procesi konkurrimi;
  - r. miraton Anëtarët e Këshillit të Etikës mbi bazën e propozimeve të bëra nga njësitë kryesore, në përbërje të të cilit janë personeli akademik me kohë të plotë, si dhe studentë;
  - s. propozon dhe miraton anëtarët e Komisioneve të Përhershme;
  - t. miraton kriteret e punësimit të personelit akademik të propozuara nga njësitë në nivel institucional, si dhe kriteret e punësimit të personelit ndihmës-akademik të propozuara nga njësia ku ky personel shërben;
  - u. emëron përfaqësuesit e tij në përbërjen e Bordit të Administrimit;
  - v. mbi bazën e propozimeve të Departamenteve, miraton kuotat dhe kriteret e pranimit për kandidatët për student në secilin program studimi, Senati nëse e sheh të arsyeshme mund të përcaktojë edhe kritere shtesë në të gjitha ciklet e studimit;
  - w. propozon në Bordin e Administrimit, ndryshime në nivelin e pagave të personelit akademik, si dhe ndryshimin e tarifës së orës mësimore.
13. Funksione të tjera të Senatit Akademik janë:
- a. mbi bazën e rezultateve të arritura nga studentët, miraton kriteret dhe listën emërore të diplomatëve që do të përfitojnë Medalje të Artë si dhe Certifikatë Ekselence, në përfundim të studimeve të tyre;
  - b. krijon Komisionin e Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, për dhënien e gradës shkencore "Doktor" dhe të titujve shkencorë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", kur institucioni plotëson kriteret ligjore, si edhe Komisionet e tjera të Përhershme sipas përcaktimeve në Statut;
  - c. zgjedh kryeredaktorin, zëvendës kryeredaktorin dhe miraton përbërjen e anëtarëve të redaksisë dhe të Bordit Drejtues të Revistës Optime;
  - d. shqyrton dhe shfuqizon, kryesisht apo me kërkesë të të interesuarit, vendimet e Komisioneve të Përhershme, kur bien ndesh me legjislacionin në fuqi, Statutin apo rregulloret përkatëse;
  - e. merr vendime mbi ndryshimet apo shfuqizimet e akteve të fakulteteve, të cilat bien ndesh me Statutin dhe rregulloret përkatëse;
  - f. me kërkesë të fakulteteve apo departamenteve, Senati Akademik mund të miratojë organizimin e sesioneve të ndërmjetme të provimeve, të jashtëzakonshme apo të kufizuara, jashtë kalendarit akademik, të riprovimeve ose të provimeve të mbartura;
  - g. propozon tarifat e studimit si dhe ndryshimet e tyre dhe ia përcjell ato për miratim Bordit të Administrimit;
  - h. propozon politikat e veçanta për trajtimin financiar të kategorive të veçanta, siç janë: studentëve të ekxelencës dhe ia përcjell ato për miratim Bordit të Administrimit.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

- i. miraton paraprakisht kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore, të formuluar nga Rektorati dhe ja paraqet ato për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit;
- j. me propozim të Bordit të Administrimit, miraton ndryshime në nivelin e pagave si dhe ndryshimin e tarifës së orës mësimore.

### Neni 14

#### Funksionimi i Senatit Akademik

1. Senati Akademik mbledhet në sesione të rregullta 3 (tre) herë në një semestër dhe drejtohet nga Rektori.
2. Mbledhjet e Senatit Akademik janë të zakonshme ose të jashtëzakonshme. Mbledhjet e jashtëzakonshme thirren me kërkesë të Rektorit ose 1/3 (një të tretat) e anëtarëve të tij. Mbledhjet e Senatit Akademik zhvillohen kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Kur nuk janë të pranishëm të paktën 1/2 (një të dytat) e anëtarëve, Rektori vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër.
3. Mbledhjet e Senatit Akademik pasqyrohen në procesverbalet e mbledhjeve që mbahen me shkrim dhe njëkohësisht mundet edhe të regjistrohen me zë. Në rastet kur bëhet regjistrim, transkriptimi i plotë i mbledhjes bëhet vetëm në raste kur një gjë e tillë është e nevojshme. Pavarësisht mënyrës së mbajtjes së procesverbalit me shkrim dhe me regjistrim, në procesverbalin me shkrim pasqyrohet me efekt pavlefshmërinë e tyre, dispozitivi i plotë i çdo vendimi të marrë.
4. Vendimet e Senatit Akademik merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe kanë të drejtë vote, me përjashtim të rasteve kur Statuti parashikon ndryshe.
5. Votimet në Senatin Akademik janë të hapura. Në raste të veçanta, bazuar në natyrën e vendimmarrjes, Senati me vendim të tij paraprak mund të vendosë që votimi të bëhet i fshehtë. Votimi i fshehtë realizohet nëpërmjet votimit me fletëvotimi ose nëpërmjet mjeteve apo sistemeve elektronike të cilat garantojnë fshehtësinë e tij.
6. Senati Akademik në ushtrimin e funksioneve të tij shprehet me vendime.
7. Mënyra e thirrjes së mbledhjeve të Senatit Akademik, rendi i ditës, votimi, çështje dhe veçori të tjera të funksionimit të tij përcaktohen në Rregulloren "Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Senatit Akademik".

### Neni 15

#### Rektori

1. Rektori është autoriteti më i lartë drejtues akademik i AU-së, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
2. Rektori mban titullin "Profesor".
3. Rektori i AU-së propozohet nga Administratori i shoqërisë tregtare dhe zgjidhet nga Senati Akademik, për një mandat 4-vjeçar, me të drejtë riemërimi vetëm një herë.



*[Handwritten signature]*



## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

4. Zgjedhja e Rektorit nga Senati Akademik, bëhet mbi bazë të kandidatuarave alternative, të cilat paraqiten nga Administratori i shoqërisë tregtare, midis radhëve të anëtarëve të personelit akademik të AU dhe/ose jashtë tij.
5. Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes së rektorit janë si më poshtë:
  - a. mban të paktën titullin “Profesor” dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit ose dhe jashtë tij;
  - b. të ketë përvojë të dëshmuar në mësimdhënie akademike dhe kërkim shkencor;
  - c. të ketë përvojë të dëshmuar menaxhuese në nivel Universiteti;
  - d. të ketë të mbrojtur të paktën një nga gjuhët e huaja të BE-së. Mbrojtja e një gjuhe të BE-së nuk është e nevojshme kur kandidati ka zhvilluar studimet e tij në një nga ciklet e studimit në një nga gjuhët e huaja të BE-së.

### NENI 15/1

#### Funksionet e Rektorit

1. Rektori kryen funksionet si më poshtë:
  - a. drejton universitetin në të gjitha aspektet e veprimtarisë së tij akademike dhe kërkimore-shkencore dhe garanton autonominë e tij;
  - b. drejton Senatin Akademik dhe raporton para tij;
  - c. drejton hartimin e planit strategjik të zhvillimit të institucionit, ia paraqet atë Senatit Akademik për miratim dhe ndjek zbatimin e tij;
  - d. paraqet propozimet për aktet që janë në kompetencë për t’u shqyrtuar nga Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Komisionet e Përhershme dhe Këshilli i Etikës së AU-së;
  - e. nënshkruan në emër të AU-së, marrëveshje dhe protokolle bashkëpunimi me të tretë dhe anëtarësimin e AU-së në shoqata dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare;
  - f. është autoriteti i vetëm vendimmarrës për sa u përket çështjeve akademike dhe protokollare me përjashtim të çështjeve që ky Statut u njehe organeve të tjera kolektive dhe monokratike, si dhe të çështjeve të cilat i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë, apo nga ligje të tjera të posaçme që parashikojnë të drejtën e vendimmarrjes për autoritete të tjera;
  - g. ka të drejtën e vetos pezulluese mbi vendimet e Senatit Akademik si Kryetar i tij, duke i kthyer ato për rishqyrtim vetëm një herë. Kur mbas rishqyrtimit Senati Akademik nuk e ndryshon vendimin, vendimi merr menjëherë formë të prerë;
  - h. mbikëqyr zbatimin e vendimeve, masave dhe kërkesave të Senatit Akademik;
  - i. shfuqizon, kryesisht apo me kërkesën e të interesuarit, aktet e Dekanit, kur bien ndesh me legjislacionin në fuqi;
  - j. nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe ndihmës-akademik në AU;
  - k. miraton ngarkesat mësimore të personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm;
  - l. miraton punësimin e personelit akademik në AU dhe nënshkruan kontratat e tyre të punës;
  - m. nënshkruan diplomat e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, pa të drejtë të regjimit të nënshkrimit;
  - n. ngrre komisione e grupe pune për qëllime studimi, kontrolli dhe veprimtari të veçanta;





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

- o. delegon funksionet e tij tek zëvendësrektori/zëvendësrektorët në rast të pamundësisë, mungesës ose pushimeve.
- p. si përfaqësues ligjor i AU-së përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretët. Rektori përfaqëson universitetin në marrëdhëniet me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe institucione të tjera të administratës publike, në marrëdhëniet me institucione të huaja dhe me institucione të tjera homologe. Kjo kompetencë mund të delegohet përveçse tek zëvendësrektorët edhe tek persona të tjerë sipas legjislacionit në fuqi përsa i përket institutit të përfaqësimit.
- q. Rektori ka të drejtë të bashkërendojë vënien në zbatim të kompetencave të Rektoratit me përfaqësuesit e tjerë të kësaj strukture.
- r. Rektori me cilësinë e drejtuesit të Rektoratit përfaqëson këtë të fundit në mbledhjet e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit.
- s. Rektori ka të drejtë t'ia delegojë kompetencën e drejtimit të mbledhjes së Senatit Akademik njërit nga Zv. Rektorët (kur ka të tillë), vetëm në kushtet kur prania e tij është e pamundur për shkaqe pune ose shëndetësore, si dhe kur mbledhja e Senatit Akademik ka karakter urgjent.
- t. Rektori ka të drejtë të thërrasë në çdo kohë mbledhjet e Rektoratit dhe të përcaktojë rendin e ditës. Vendimet e mbledhjes së Rektoratit janë të detyrueshme për zbatim nga çdo strukturë tjetër akademike dhe administrative në varësi.
- u. Rektori garanton autonominë e universitetit dhe ka kompetencë sipas Statutit të paraqesë propozime pranë Senatit Akademik, Bordit të Administrimit dhe Këshillit të Etikës. Ai ka të drejtë të kontrollojë në mënyrë periodike zbatimin e vendimeve të organeve drejtuese individuale dhe kolegjiale të universitetit, si dhe gëzon në mënyrë ekskluzive të drejtën për të nënshkruar diplomat, certifikatat dhe çdo shkrësë tjetër administrative që përfaqëson vullnetin e organeve më të larta drejtuese të universitetit.
- v. Rektori organizon të gjithë veprimtarinë e tij për rritjen e cilësisë së procesit mësimor dhe kërkimor të universitetit, duke mbajtur përgjegjësi për të gjithë aktivitetin me natyrë akademike dhe administrative në vartësi të tij. Rektori ka të drejtë të paraqesë në organet drejtuese kolegjiale të universitetit çdo lloj propozimi apo rekomandimi që synon të përmirësojë, të ndryshojë apo të shmangë çështje që kanë impakt në jetën akademike dhe administrative universitare.
- w. Rektori krijon marrëdhënie autoriteti hierarkike, akademike, me personelin mësimdhënës dhe ndihmës të të gjitha niveleve, duke kërkuar përgjegjësi, disiplinë dhe zbatim të plotë të legjislacionit në fuqi dhe akteve normuese të universitetit. Rektori është autoriteti më i lartë i zgjidhjes përfundimtare të çdo ankese, kërkesë apo komunikimi në marrëdhënie me personelin akademik, joakademik dhe me studentët.
- x. Rektori cdo kompetencë tjetër që me ligj ose me akte të tjera nënligjore apo me këtë Statut nuk i është dhënë ndonjë organi tjetër.
- y. Rektori disponon sipas rastit me vendim, urdhër, udhëzim apo çdo akt tjetër të përshtatshëm.
- z. Rektori ka të drejtë që në ushtrim të autoritetit të tij të lëshojë urdhra të detyrueshme për zbatim, të caktojë afate dhe përgjegjësi konkrete për strukturat në vartësi të tij dhe të





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

kërkojë informacion për ecurinë e zbatimit të tyre në çdo kohë. Çdo akt i rektorit ose i një personi tjetër që e merr atë mbi bazën e delegimit të kompetencës nga rektori sipas përcaktimeve të këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi, duhet të jetë i arsyetuar ndryshe është i pavlefshëm.

aa. Rektori ka të drejtë të delegojë detyrat e tij pranë Zv.Rektorëve por në asnjë rast kompetenca për të cilat legjislacioni në fuqi, Statuti dhe Rregullorja e Përgjithshme e Universitetit kanë caktuar ekskluzivisht vetëm autoritetin e tij në vendimmarrje.

2. Mandati i Rektorit përfundon:

- a. me mbarimin e mandatit;
- b. me dhënien e dorëheqjes;
- c. me largimin nga universiteti si personel akademik;
- d. në raste paaftësie fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
- e. me propozim të Administratorit të shoqërisë tregtare, për raste të shkeljeve të rënda të parashikuara në Kodin e Etikës ose në rastin e shkeljeve të rënda të ligjit;
- f. kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që cënon rëndë figurën dhe integritetin e tij në ushtrimin e këtij funksioni.

3. Në rastin e dorëheqjes, apo largimit të Rektorit sipas pikës 6 të këtij neni, Administratori i shoqërisë tregtare i propozon Senatit Akademik, nga radhët e personelit akademik ekzistues ose/dhe jashtë tij, dy kandidatura alternative, prej të cilëve zgjidhet Rektori i ri. Deri në emërimin e rektorit të ri funksionet e tij përmbushen nga Zëvendësrektori Përgjegjës për Procesin Mësimor në Albanian University.

### Neni 16

#### Zëvendësrektorët

1. Albanian University ka tre Zëvendësrektorë:

- a. Zv. Rektor për Procesin Mësimor;
- b. Zv. Rektor për Kërkimin Shkencor;
- c. Zv. Rektor për Politikën e Zhvillimit Institucional.

2. Zëvendësrektor mund të jetë vetëm një anëtar i personelit akademik me kohë të plotë, i kategorisë "Profesor" ose "Profesor i asociuar" ose të ketë gradën shkencore "Doktor" (Ph.D) të fituar pranë Universiteteve të vendeve anëtare të OECD ose BE-së.

3. Rektori i propozon Senatit Akademik kandidatët për Zëvendësrektor, i cili vlerëson plotësimin e kërkesave të mësipërme dhe miraton ose jo kandidaturën e propozuar.

4. Zëvendësrektorët sipas rastit ndjekin me përgjegjësi çështjet e ecurisë së procesit mësimor, kërkimit shkencor, si dhe politikën e zhvillimit Institucional. Ata ndihmojnë Rektorin në realizimin e detyrave të tij dhe mund të ushtrojnë edhe detyra të tjera bazuar në urdhrin e Rektorit.

5. Në rast mungese të tij, Rektori autorizon njërin prej Zëvendësrektorëve në ushtrimin e detyrave të tij, me përjashtim të rastit kur në këtë Statut përcaktohet ndryshe.

6. Marrëdhëniet e Zëvendësrektorit me organet e tjera, në të gjithë Universitetin, dhe detyrat e tjera të Zv. Rektorëve përcaktohen në aktet rregullatore të AU-së.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

### Neni 17

#### Rektorati

1. Rektorati është organ kolegjal në nivel universiteti, i cili drejtohet nga Rektori dhe përbëhet nga:
  - a) Rektori;
  - b) Zëvendësrektorët;
  - c) Administratori i Përgjithshëm i AU-së;
  - d) Dekanët e fakulteteve të AU-së.
2. Funkcionet kryesore të Rektoratit janë:
  - a. harton planin strategjik të zhvillimit të institucionit, mbështetur në propozimet e departamenteve dhe fakulteteve të AU-së, si dhe ato të Administratorëve të njësive kryesore dhe ja paraqet për miratim Senatit Akademik;
  - b. harton programin vjetor të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, mbi bazë të propozimeve të departamenteve dhe fakulteteve, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit nga Senati Akademik;
  - c. harton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore pasi merr raportet nga çdo fakultet dhe ia paraqet për miratim Senatit Akademik;
  - d. paraqet rekomandime për projektet për programet e studimeve, projektet e kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
  - e. mbikëqyr zbatimin për të gjitha vendimet e miratuara nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit;
  - f. monitoron veprimtarinë akademike të AU-së dhe publikon rezultatet e vlerësimit të tij;
  - g. harton rregulloren e funksionimit të tij, e cila miratohet nga Senati Akademik;
  - h. ushtron kontrolle të organizuara apo spontane në njësitë e AU-së për përmbushjen e objektivave të Institucionit, si dhe për zbatimin e akteve rregullatore të organeve të AU-së.
3. Rektori ka të drejtë në çdo kohë të thërrasë mbledhjen e Rektoratit dhe të propozojë rendin e ditës. Rendi i ditës miratohet në mbledhjen e Rektoratit me shumicën e votave nga anëtarët e pranishëm.
4. Rektorati kërkon mendimin e Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit për aspekte të kompetencës së këtyre të fundit.
5. Rektorati raporton një herë në semestër në Senatin Akademik dhe në Bordin e Administrimit për realizimin e planit të veprimtarive.
6. Rektorati merr vendim vetëm nëse ka kuorum ( nëse në mbledhje marrin pjesë më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve).
7. Rektorati i aprovon vendimet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.
8. Bashkëpunimi me organet e tjera:
  - a. Rektorati është autoriteti përgjegjës kryesor për vënien në zbatim të vendimeve të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për aq kohë sa këto vendime adresojnë dhe vijnë për këtë organ.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

- b. Për çështje dhe detyra specifike, Rektorati ka të drejtë t'u delegojë kompetenca të veçanta organeve dhe personelit akademik dhe administrativ të universitetit kur e gjykon të drejtë një gjë të tillë.

### Neni 18

#### Njësitë pranë Rektoratit

- Pranë Rektoratit, funksionojnë struktura ndihmës-akademike, në mbështetje të procesit akademik dhe atij kërkimor-shkencor, si më poshtë vijon:
  - Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike (- njësia e projekteve kërkimore);
  - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;
  - Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave;
  - Zyra e Regjistrimeve dhe Transferimeve;
  - Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë;
  - Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve (tutoriatit & mentorimi);
  - Zyra e Karrierës dhe Alumnit.
- Secila nga këto njësi ka strukturën e saj dhe ushtron veprimtari sipas përcaktimeve në Rregulloren e Përgjithshme të AU-së dhe në rregulloret e veçanta, që miratohen nga Senati Akademik.

### Neni 19

#### Komisionet e Përhershme

- Komisionet e Përhershme janë organe kolegjiale që kryejnë funksione në fusha të caktuara, që lidhen kryesisht me kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik, garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikat e AU-së.
- Komisionet e Përhershme në AU krijohen nga Senati Akademik.
- Komisionet e Përhershme që funksionojnë në AU janë:
  - Komisioni për Dhënie të Gradës Shkencore "Doktor";
  - Komisioni për promovimin e personelit akademik për titujt "Profesor i asociuar" dhe "Profesor";
  - Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin;
  - Komisioni për Vlerësimin Institucional;
  - Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimin.
- Secili nga këto komisione ka në përbërje të tij 5 (pesë) anëtarë. Anëtarët vetëkandidohen dhe miratohen nga Senati Akademik për një mandat 2-vjeçar, me të drejtë riemërimi, sipas përcaktimeve të këtij Statuti.
- Anëtarët e dy komisioneve të përcaktuar në gerat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, duhet të mbajnë titullin akademik "Profesor" dhe "Profesor i asociuar".
- Në komisionet e parashikuara në pikën 3, gerat "c", "d" dhe "e" të këtij neni janë të përfaqësuar edhe studentët e AU-së, të cilët zgjidhen nga Këshilli Studentor.
- Funksionet dhe organizimi i komisioneve të përhershme përcaktohen në këtë Statut dhe Rregulloren e Përgjithshme të AU-së.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

### Neni 20

#### Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”

1. Komisioni për dhënien e gradës “Doktor” është organ kolegjal vendimmarrës dhe këshillimor që ngrihet pranë universitetit nga Senati Akademik për organizimin dhe drejtimin e studimeve të doktoratës.
2. Komisioni për dhënien e gradës “Doktor” ka në përbërje të tij 5 (pesë) anëtarë. Anëtarët e këtij komisioni janë të zgjedhur nga Senati Akademik për një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, mbi bazë të propozimeve nga Asambleja e personelit akademik. Anëtarët e Komisionit për dhënien e gradës “Doktor” duhet të mbajnë titullin shkencor “Prof” dhe “Prof.asoc”.
3. Komisioni për dhënien e gradës “Doktor” mundëson kualifikimin e studentëve pas ciklit të dytë të studimeve dhe pas programeve doktorale, si dhe bashkëpunon me Komisionet e tjera analoge për dhënien e gradës “Doktor” të institucioneve të tjera të Arsimit të Lartë.
4. Komisioni për dhënien e gradës “Doktor” siguron një marrëdhënie të ngushtë me njësitë bazë dhe kryesore të Universitetit lidhur me kriteret dhe vlerësimin e kandidaturave të studentëve që aplikojnë për programet e ciklit të tretë akademik sipas kriterëve përkatëse.
5. Komisioni për dhënien e gradës “Doktor” pranon, konsulton dhe vlerëson të gjithë dokumentacionin studimor të doktorantëve duke marrë vendime për fazat e ndërmjetme të studimit dhe për mbrojtjen përfundimtare të gradës shkencore “Dr”.
6. Organizimi dhe funksionimi i Komisionit për dhënien e gradës shkencore “Doktor” dhe çështje të tjera që lidhen me veprimtarinë e tij, përcaktohen në rregulloren e programit të Doktoraturës.

### Neni 21

#### Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik për titujt “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”

1. Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik për titujt shkencorë “Prof.asoc”, dhe “Prof” ka në përbërje të tij 5 (pesë) anëtarë. Anëtarët e këtij komisioni janë të zgjedhur nga Senati Akademik për një mandat 2 (dy) vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje mbi bazë të propozimeve nga Asambleja e Personelit Akademik. Anëtarët e Komisionit për dhënien e titullit shkencor duhet të mbajnë vetëm titullin shkencor “Prof.”
2. Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik për titujt shkencorë “Prof.asoc” dhe “Prof.” mundëson kualifikimin pas studimeve doktorale si dhe bashkëpunon me komisionet e tjera analoge për dhënien e titullit shkencor “Prof.asoc” dhe “Prof” të institucioneve të tjera të Arsimit të Lartë.
4. Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik për titujt shkencorë “Prof.asoc” dhe “Prof.” siguron një marrëdhënie të ngushtë me njësitë bazë kryesore të Universitetit lidhur me kriteret dhe vlerësimin e kandidaturave që të aplikojnë për marrjen e titujve shkencorë për t'u nënshprehur në respektim të kriterëve ligjore.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

5. Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik për titujt shkencorë "Prof.asoc" dhe "Prof." konsulton dhe vlerëson të gjithë dokumentacionin studimor të kandidatit i cili gëzon titullin "Dr" duke marrë vendime përfundimtare.
6. Organizimi dhe funksionimi i komisionit për Promovimin e Personelit Akademik për titujt shkencorë "Prof.asoc." dhe "Prof." bazohet në aktet nënligjore në fuqi për arsimin e lartë.

### Neni 22

#### Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin

1. Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin është organ kolegjal vendimmarrës dhe këshillimor që ngrihet pranë universitetit nga Senati Akademik.
2. Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin ka në përbërje të tij 5 (pesë) anëtarë, ku 4 (katër) anëtarët e këtij komisioni, të cilët janë staf akademik zgjidhen nga Senati Akademik mbi bazë të propozimeve nga Asambleja e Personelit Akademik ndërsa anëtari i pestë është student, dhe zgjidhet nga Këshilli Studentor. Anëtarët e këtij Komisioni zgjidhen për një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Komisioni kontrollon veprimtarinë e Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, mbi bazën e një raportimi periodik 6 mujor nga kjo e fundit.
4. Mbledhjet e Komisionit quhen të vlefshme, në rast se në të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të gjithë anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje. Në rast barazimi, vota e kryetarit të mbledhjes është vendimtare. Komisioni mbledhet në mbledhje të zakonshme të paktën një herë në tre muaj veprimtaria e të cili është si më poshtë:
  - a) Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin përcakton drejtimit kryesore, në lidhje me fizionominë e institucionin për natyrën e programeve të studimit dhe titujve që ai duhet të ofrojë.
  - b) Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin është përgjegjës për përcaktimin e politikave orientuese në drejtim të hapjes së programeve të reja të studimit, si dhe të përmirësimit të atyre ekzistuese në përputhje me Standardet Shtetërorë të Cilësisë në Arsimin e Lartë, dhe atyre të Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL).
  - c) Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin, i propozon Senatit Akademik, pasi ka marrë edhe mendimin e Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, nevojën e ndryshimeve në kurrikula dhe programe studimi, në përputhje me nevojat e tregut.
  - d) Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin, në raste të caktuara kur e shikon të arsyeshme, mund të zhvillojë edhe mbledhje të përbashkëta me Komisionin e Vlerësimit Institucional apo me Komisione të tjera për nevojat e institucionit, në drejtim të përcaktimit të politikave orientuese për hapjen e programeve të reja, rifreskimit të atyre ekzistuese si dhe çështje të tjera të natyrës mësimore dhe akademike.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

5. Funkcionet dhe organizimi i Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin përcaktohen edhe në rregulloren përkatëse të Komisionit bazuar në nenet e këtij Statuti.

### Neni 23

#### Komisioni për Vlerësimin Institucional

1. Komisioni për Vlerësimin Institucional (KVI) është organ kolegjal vendimmarrës dhe këshillimor që ngrihet pranë universitetit nga Senati Akademik për organizimin dhe drejtimin e vlerësimin institucional.
2. Komisioni për Vlerësimin Institucional ka në përbërje të tij 5 (pesë) anëtarë, ku 4 (katër) anëtarët e këtij komisioni, të cilët janë staf akademik zgjidhen nga Senati Akademik mbi bazë të propozimeve nga Asambleja e Personelit Akademik. Anëtari i pestë është student i cili zgjidhet nga Këshilli Studentor. Anëtarët e këtij Komisioni zgjidhen për një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Komisioni për Vlerësimin Institucional është përgjegjës për ngritjen, funksionimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të Sistemit të Brendshëm të Cilësisë në AU, mbështetur në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe standardet për Sigurimin e Cilësisë në HEAL.
4. Komisioni për Vlerësimin Institucional kontrollon veprimtarinë e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, mbi bazën e një raportimi periodik 6 mujor nga kjo e fundit.
5. Mbledhjet e Komisionit për Vlerësimin Institucional quhen të vlefshme, në rast se në të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje. Në rast barazimi, vota e kryetarit të mbledhjes është vendimtare.
6. Komisioni ushtron këto funksione:
  - a) Përcaktimin e objektivave strategjike afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të vlerësimit institucional, në përputhje me misionin, vizionin dhe gjendjen e AU-së.
  - b) Monitorimin e vlerësimit të mësimdhënies, si edhe çdo veprimtari tjetër akademike, zhvillimin e cilësisë dhe miratimin e standardeve të cilësisë, në përputhje me planin strategjik dhe misionin e AU-së, bazuar në raportimin e NJSBC-së.
  - c) Analizimin e modeleve të ndryshme, në kuadër të përmirësimit të cilësisë, që mund të merren si shembull, si edhe shpërndarjen e tyre pranë njësive akademike.
  - d) Propozimin e aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë në të gjithë institucionin, bazuar në problemet e evidentuara nga analiza "SWOT".
  - e) Shqyrtimin e raportit vjetor të NJSBC-së, dhe kalimin e tij për miratim në Senatin Akademik.
7. Funkcionet dhe organizimi i Komisionit për Vlerësimin Institucional përcaktohen edhe në rregulloren përkatëse të Komisionit bazuar në nenet e këtij Statuti





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

### Neni 24

#### Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimin

1. Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimin është organ kolegjal vendimmarrës dhe këshillimor që ngrihet pranë universitetit nga Senati Akademik për organizimin dhe drejtimin e Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike.
2. Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimin ka në përbërje të tij 5 (pesë) anëtarë, ku 4 (katër) anëtarët e këtij komisioni, të cilët janë staf akademik zgjidhen nga Senati Akademik mbi bazë të propozimeve nga Asambleja e Personelit Akademik. Anëtari i pestë është student i cili zgjidhet nga Këshilli Studentor.
3. Anëtarët e Komisionit për Kërkimin Shkencor dhe Botimin zgjidhen për një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
4. Mbledhjet e Komisionit për Kërkimin Shkencor dhe Botimin quhen të vlefshme, në rast se në të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje. Në rast barazimi, vota e kryetarit të mbledhjes është vendimtare.
5. Komisioni mblidhet në mbledhje të zakonshme të paktën një herë në tre muaj. Në raste të nevojshme, kryetari mund të thërrasë mbledhjen e jashtëzakonshme. Për çështje të caktuara, ai kërkon që në mbledhjet e Komisionit për Kërkimin Shkencor dhe Botimin pa të drejtë vote të marrin pjesë edhe përfaqësues të organeve drejtuese të institucionit, dhe/ose persona të tjerë nga stafi akademik.
6. Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimin formulon dhe orienton politikat e zhvillimit të veprimtarisë kërkimore - shkencore në vijimësi, për sa më poshtë:
  - a. bashkërendon dhe koordinon punën kërkimore-shkencore të fakulteteve dhe departamenteve, duke respektuar liritë akademike të stafit akademik dhe drejtues;
  - b. promovon veprimtarinë kërkimore-shkencore të universitetit, brenda e jashtë vendit;
  - c. nxit pedagogë e drejtues të departamenteve dhe fakulteteve për punë kërkimore-shkencore dhe pjesëmarrjen e tyre, si individë në projekte në shkallë departamenti, fakulteti, universiteti, kombëtare dhe ndërkombëtare;
  - d. ndjek zbatimin e orientimeve, të planeve, të projekteve dhe të tematikës e problematikës së miratuar në departamente; raporton sistematikisht në Senatin Akademik të universitetit dhe merr detyra prej tij.
7. Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimin, në zbatim të këtij Statuti ka të drejtë të aplikojë, në emër të AU-së pranë AKKSHI-t për marrjen e grantit të punës kërkimore-shkencore, ku bëjnë pjesë edhe fondet për kërkimin shkencor.
8. Funkcionet dhe organizimi i Komisionit për Kërkimin Shkencor dhe Botimin përcaktohen dhe në rregulloren përkatëse të Komisionit bazuar në nenet e këtij Statuti.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

### Neni 25

#### Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës është organ kolegjal këshillimor i AU-së që promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit akademik dhe atij kërkimor-shkencor dhe në veprimtaritë e tjera institucionale sipas parashikimeve të Kodit të Etikës dhe legjislacionit në fuqi.
2. Këshilli i Etikës është organi përgjegjës për dhënien e masave disiplinore të propozuara nga autoritetet drejtuese ndaj stafit akademik, administrativ dhe studentëve, në rast mospërbushjeje të detyrimeve që burojnë nga ligji, Statuti, rregulloret dhe udhëzime të tjera si brenda ashtu dhe jashtë institucionit.
3. Anëtarët e Këshillit të Etikës emërohen nga Senati Akademik, mbi bazën e propozimit të Rektorit. Këshilli i Etikës zgjedh kryetarin e tij me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të tij. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Etikës është 4 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje. Kryetari i Këshillit të Etikës i përket kategorisë Profesor ose Profesor i asociuar.
4. Anëtarët e Këshillit të Etikës kanë detyrimin të deklarojnë paraprakisht papajtueshmërinë e funksionit të tyre me procedimin etik në vijim për shkak të një konflikti interesi me palët.
5. Këshilli i Etikës thirret në mbledhje nga Kryetari për çështje që propozohen dhe paraqiten nga strukturat dhe njësitë e Universitetit, si dhe në bazë të ankesave për incidente apo ngjarje të ndryshme në Universitet.
6. Këshilli i Etikës së AU-së përbëhet nga një përfaqësues për çdo njësi kryesore të tij, një nga personeli ndihmës-akademik, një përfaqësues nga personeli administrativ dhe një përfaqësues i studentëve.
7. Këshilli i Etikës respekton të drejtat e palëve për t'u dëgjuar, apeluar, paraqitur prova dhe për t'u dhënë kohë palëve brenda një afati të arsyeshëm si dhe çdo aspekt tjetër të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Çdo palë e përfshirë në një procedim të etikës është e detyruar të respektojë thirrjet, njoftimet dhe vendimet e Këshillit të Etikës.
8. Çdo subjekt në universitet që preket nga vendimmarrja e Këshillit të Etikës ka të drejtën e ankimit sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Etikës.
9. Mbledhjet e Këshillit të Etikës quhen të vlefshme në rast se në të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve. Vendimet merren me dy të tretat e të gjithë anëtarëve pjesëmarrës.
10. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Etikës bazuar në këtë Statut përcaktohet edhe në Rregulloren e Brendshme si dhe në Rregulloren e Funksionimit të Këshillit të Etikës në AU.
11. Mënyra e veprimtarisë së Këshillit të Etikës në lidhje me shqyrtimin e ankesave, vendimet dhe sanksionet përkatëse, si dhe ekzekutimi i këtyre vendimeve parashikohen në Kodin e Etikës, i cili miratohet nga Këshilli i Etikës.

### Neni 26

#### Fakulteti

1. Fakulteti është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në bazën të përafërta ose të ndërthurura.
2. Fakulteti ofron programe në të tre ciklet e studimit, si dhe ato me karakter profesional.
3. Fakultetet në AU janë të organizuara në departamente (njësi bazë), si më poshtë:





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

- I. Fakulteti i Shkencave Mjekësore
    1. Departamenti i Stomatologjisë
    2. Departamenti i Farmacisë
    3. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
  - II. Fakulteti i Shkencave Shoqërore
    1. Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative
    2. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme
    3. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes
  - III. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
    1. Departamenti i Art Dizajnit
    2. Departamenti i Inxhinierive
    3. Departamenti i Shkencave Ekonomike
4. Fakulteti drejtohet nga Dekani, i cili është autoriteti më i lartë akademik dhe përfaqësues i tij.
5. Hapja, riorganizimi ose mbyllja e fakultetit në AU bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, mbi bazën e propozimit të AU-së, pas miratimit nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit.
6. Funkionimi i fakulteteve në AU përcaktohet në Rregulloret e Fakulteteve të hartuara në përputhje me këtë Statut.

### Neni 27

#### Asambleja e Personelit Akademik

1. Asambleja e Personelit Akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i Fakultetit.
2. Asambleja e Personelit Akademik mbledhet të paktën një herë gjatë vitit akademik.
3. Asambleja e Personelit Akademik ka këto funksione:
  - a. zgjedh anëtarët e personelit akademik, të cilët do të përfaqësojnë fakultetin në Senatin Akademik sipas përcaktimeve në Statut;
  - b. i propozon Senatit Akademik anëtarë nga personeli akademik, që do të jenë pjesë në komisionet e përhershme të AU-së;
  - c. jep mendime për rregulloren e institucionit për çështje brenda fushës së kompetencave të saj kur kjo kërkohet nga Senati Akademik.
  - d. propozon programe të reja studimi ose kërkimi shkencor, hapje, ndryshim ose mbyllje departamentesh ose njësis të tjera.
4. Asambleja e Personelit Akademik thirret për mbledhje nga Dekani i cili përcakton edhe rendin e ditës së mbledhjes, duke mbajtur parasysh sugjerimet e anëtarëve të tjerë dhe nevojat e njësisë kryesore.
5. Vendimet e Asamblesë së Personelit Akademik merren me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve pjesëmarrës.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

6. Mënyra e funksionimit të Asamblesë së Personelit Akademik bazuar në këtë Statut përcaktohet edhe në rregulloren e njësisë kryesore.

### Neni 28

#### Dekani

1. Dekani është autoriteti më i lartë akademik drejtues i fakultetit dhe përfaqësues i tij. Ai koordinon, organizon, drejton, kontrollon dhe përgjigjet për ecurinë e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor.
2. Dekani propozohet nga Rektori dhe zgjidhet nga Senati Akademik mbi bazë të një procesi konkurrimi të kandidatave alternative.
3. Dekani mban titullin akademik "Profesor" ose "Profesor i asociuar".
4. Mandati i tij zgjat 4 (katër) vjet, me të drejtë riemërimi vetëm një herë.
5. Dekani kryen këto funksione:
  - a. drejton veprimtarinë mësimore dhe shkencore në fakultet;
  - b. koordinon veprimtarinë e departamenteve dhe organeve të fakultetit dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre;
  - c. përgatit propozimin/vendimin përkatës për çdo vendimmarrje/kërkesë/propozim të njësisë bazë dhe e përcjell në njësitë/strukturat e tjera;
  - d. shqyrton dhe miraton kalendarin e veprimtarive akademike të propozuar nga përgjegjësit e njësisë bazë;
  - e. shqyrton dhe miraton kërkesën për ndërprerjen e studimeve të studentëve në rastet e parashikuara në Rregulloren e Brendshme të AU-së;
  - f. përcjell te Rektori kërkesat për programet e dyta, pasi i analizon ato;
  - g. miraton në bllok vendimet e Komisioneve të Njohjes së Krediteve dhe Transferimit të Studimeve;
  - h. shqyrton dhe miraton sezonet e mbrojtjes së temës së diplomës, provimet e formimit dhe komisionet e tyre me propozim të përgjegjësve të departamenteve;
  - i. nënshkruan diplomën, listën e notave dhe suplementin e diplomës pa të drejtë delegimi;
  - j. përfaqëson fakultetin dhe njësitë bazë në marrëdhëniet me të tretë;
  - k. shfuqizon aktet e përgjegjësit të departamentit;
  - l. kryeson Komisionet e Vlerësimit për përzgjedhjen e personelit akademik;
  - m. drejton Asamblenë e Personelit Akademik të fakultetit;
  - n. përcjell propozimet përkatëse të departamenteve në instancat më të larta, shoqëruar me mendimet/rekomandimet e tij;
  - o. përgjigjet para Senatit Akademik për mbarëvajtjen e aktivitetit të fakultetit;
  - p. i propozon Komisionit të Përhershëm "Për kurrikulat dhe mësimin" hapjen apo mbylljen e programeve të studimit të departamenteve apo njësisë të veçanta në fakultet, si dhe ndryshimin/riorganizimin e planeve mësimore, mbi bazën e procedurave përkatëse të përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme;
  - q. i propozon Rektorit shkarkimin e drejtuesit të departamentit në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të Ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së AU-së;





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

- r. i propozon Administratorit të Përgjithshëm të AU-së, shkarkimin e Administratorit të fakultetit.
6. Dekani, në ushtrim të funksioneve të tij, shprehet, sipas rastit me vendime, urdhra dhe udhëzime apo çdo akt tjetër të përshtatshëm.
  7. Marrëdhëniet e Dekanit me organet e tjera të Universitetit, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij, përveç këtij Statuti parashikohen në Rregulloren e Fakultetit dhe në Rregulloren e Njesisë.

### Neni 29 Dekanati

1. Në AU, Dekanati është organ kolegjal që drejtohet nga Dekani dhe përbëhet nga:
  - a. Dekani;
  - b. Zëvendësdekani/ët;
  - c. Administratori i fakultetit;
  - d. Drejtuesit e departamenteve.
2. Zëvendësdekanët janë anëtarë me kohë të plotë të personelit akademik. Ata emërohen dhe shkarkohen nga Dekani, sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Përgjithshme të AU-së.
3. Dekanati kryen këto funksione:
  - a. Dekanati harton planin strategjik vjetor të zhvillimit të fakultetit, mbështetur në propozimet e departamenteve të tij, si dhe ato të Administratorit të fakultetit;
  - b. Dekanati mbikëqyr veprimtarinë e departamenteve;
  - c. shqyrton analizën vjetore të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të njësive bazë dhe harton analizën vjetore të njësisë kryesore;
  - d. miraton projektbuxhetin e njësisë kryesore;
  - e. koordinon veprimtaritë e njësive bazë dhe i orienton ato gjatë ushtrimit të detyrave të tyre;
  - f. miraton listën e periodikëve shkencorë ku do të pajtohet fakulteti, si edhe titujt e librave që do të blihen për bibliotekën e fakultetit, sipas propozimeve të strukturave përbërëse;
  - g. ushtron çdo kompetencë tjetër që me ligj ose me akte të tjera nënligjore apo me këtë Statut nuk i është dhënë ndonjë organi tjetër brenda fushës së veprimtarisë së fakultetit që ai drejton.
4. Funksionet e Dekanatit bazuar në këtë Statut përcaktohen edhe në Rregulloren e Përgjithshme si dhe rregulloret e tjera të AU-së





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

### Neni 30

#### Drejtuesi i Departamentit

1. Drejtuesi i departamentit është autoriteti drejtues akademik i departamentit dhe përfaqësues i tij.
2. Drejtuesi i departamentit propozohet nga Dekani, mbi bazën e kandidatave alternative dhe emërohet nga Rektori në bazë të një procesi konkurrimi, për një mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë riemërimi vetëm një herë.
3. Drejtuesi i departamentit mban titullin “Profesor”, “Profesor i asociuar” ose gradën shkencore “Doktor” (“Ph.D.”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të kandidojë për drejtues edhe lektori, i cili mban gradën shkencore “Doktor”.
4. Drejtuesi i departamentit ushtron këto funksione:
  - a. organizon dhe drejton punën për hartimin e planeve dhe programeve mësimore për lëndët që mbulon departamenti dhe ndjek zbatimin e tyre;
  - b. i paraqet Dekanit kandidatët për personel akademik dhe personel akademik i ftuar;
  - c. i propozon Dekanit masa për shkelje të disiplinës në punë nga personeli akademik i departamentit;
  - d. harton në mënyrë periodike analizën e punës mësimore dhe kërkimore të departamentit dhe propozon e merr masa për përmirësimin e mëtejshëm të saj;
  - e. përfaqëson departamentin dhe vepron në emër të tij në marrëdhënie me Dekanin, Senatin, Rektorin dhe Bordin;
  - f. në emër të departamentit bën përpjekje të vazhdueshme për krijimin e lidhjeve me institucione homologe dhe promovimin e departamentit;
  - g. organizon veprimtari të cilat promovojnë arritjet e departamentit nëpërmjet nxitjes së botimeve didaktike-shkencore, përfshirjes ose bashkëpunimit në projekte dhe përditësimin të rubrikave në faqen e web të AU-së;
  - h. ndjek dhe përgjigjet për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore të departamentit;
  - i. organizon dhe drejton punën për hartimin e teksteve mësimore për lëndët që mbulon departamenti;
  - j. kryen shpërndarjen e ngarkesës mësimore dhe asaj kërkimore të departamentit;
  - k. bashkëpunon me sekretarinë mësimore në trajtimin e problemeve lidhur me cilësinë e mësimdhënies dhe frekuentimin e përvetësimit e dijeve nga studentët;
  - l. miraton komisionet e provimeve;
  - m. propozon përbërjen e komisioneve për provimet e formimit dhe mbrojtjen e temave të diplomave.
4. Funksionet e drejtuesit të departamentit përcaktohen në Statut në Rregulloren e Përgjithshme të AU-së, si dhe në mënyrë të detajuar në Rregulloret e Fakulteteve dhe Departamenteve.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

### Neni 31

#### Departamenti

1. Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplina mësimore respektive.
2. Departamenti është përgjegjës për programet e studimit që ofron.
3. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore.
4. Departamenti në AU ka në përbërje të tij të paktën 7 (shtatë) anëtarë, të punësuar si personel akademik me kohë të plotë, nga të cilët të paktën 3 (tre) janë me grada shkencore ose tituj akademikë. Departamenti ka në përbërje të tij edhe personel ndihmës-akademik.
5. Departamenti mund të organizohet në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor.
6. Departamenti ka këto funksione kryesore:
  - a. i propozon Senatit Akademik sipas standardeve të cilësisë, për çdo program studimi, kriteret dhe numrin e studentëve në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij si dhe në zbatim të kriterëve ligjore në fuqi;
  - b. përzgjedh studentët fitues, për programet e studimit që ofron të cilët miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, sipas procedurave të përcaktuara në Statutin dhe rregulloret e AU-së;
  - c. propozon te Dekani hapjen, riorganizimin ose mbylljen e programeve të studimit, i cili i përcjell pranë instancave më të larta;
  - d. propozon kriteret e pranimeve në tri ciklet e studimit për secilin program studimi që ofron;
  - e. propozon tarifën e shkollimit për secilin program studimi që ofron.
7. Departamenti mund të ofrojë shërbime për të tretë mbi bazën e marrëveshjeve përkatëse të miratuara nga Senati Akademik dhe të zhvillojë veprimtari të tjera, sipas Statutit dhe akteve të brendshme të AU-së. Në kuadër të realizimit të kërkimit shkencor dhe zhvillimit të praktikave mësimore, departamenti organizon dhe mundëson shërbime për të tretë. Shërbimet për të tretët realizohen edhe nëpërmjet veprimtarisë së njësisë të shërbimit pranë AU-së, sipas përcaktimeve në këtë Statut.
8. Funksionet e departamentit bazuar në këtë Statut përcaktohen në mënyrë të detajuar dhe në Rregulloren e Fakultetit dhe Departamentit.
9. Hapja, riorganizimi ose mbyllja e njësisë bazë/departamenteve në AU bëhet me vendim të Senatit Akademik, në përfundim të vitit akademik, pas miratimit nga Bordi i Administrimit. AU-ja njofton ministrinë përgjegjëse për arsimin brenda një afati 30 (tridhjetë) ditor.



*[Handwritten signature]*



## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

### PJESA E DYTË ORGANIZIMI ADMINISTRATIV

#### Neni 32

#### Bordi i Administrimit

1. Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të AU-së, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.
2. Bordi i Administrimit të AU-së përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, 3 (tre) anëtarë prej të cilëve janë pjesë e personelit akademik të AU-së dhe emërohen nga Senati Akademik, 3 (tre) anëtarë të tjerë emërohen nga Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë Tregtare dhe 1 (një) anëtar i Bordit të Administrimit i cili është vetë Administratori i shoqërisë tregtare dhe mban pozicionin e Kryetarit të Bordit.
3. Mandati i anëtarëve të emëruar nga Senati Akademik është 5 (pesë) vjet.
4. Bordi i Administrimit të AU-së ushtron këto funksione:
  - a. garanton qëndrueshmërinë financiare të AU-së dhe përmbushjen e misionit të tij;
  - b. me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të AU-së dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
  - c. me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm 3-vjeçar të AU-së, të hartuar nga Administratori i Përgjithshëm dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
  - d. me propozim të Senatit Akademik, miraton strukturën e AU-së dhe numrin e personelit akademik në të gjitha nivelet;
  - e. me propozim të Senatit Akademik, miraton tarifën e studimit për çdo vit akademik;
  - f. vlerëson paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e programeve të studimit të AU-së. Programet e reja dhe riorganizimet e programeve të studimit duhet të jenë të mbështetura në projektbuxhetin vjetor të AU-së;
  - g. miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të AU-së;
  - h. vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e universitetit, si dhe ndarjen ose bashkimin e AU-së me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
  - i. miraton paraprakisht projekt Statutin e AU-së para se t'i përcillet Senatit Akademik;
  - j. jep mendim për Projekt Rregulloren e AU-së dhe miraton Rregulloren Financiare të tij;
  - k. miraton kriteret për hartimin e projekt buxhetit vjetor dhe atij afatmesëm dhe rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron AU-ja nga ushtrimi i veprimtarive të saj, të propozuara nga Administratori i Përgjithshëm;
  - l. është përgjegjës për caktimin e kriteve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore të AU-së;
  - m. emëron dhe shkarkon Administratorin e Përgjithshëm të AU-së, mbi bazën e propozimeve të Administratorit të shoqërisë tregtare;
  - n. miraton raportin vjetor të veprimitarisë financiare të AU-së, të hartuar nga Administratori i Përgjithshëm;
  - o. me propozim të Senatit Akademik, miraton ndryshime në nivelin e masive të personelit akademik, si dhe ndryshimin e tarifës së orës mësimore;





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

- p. me propozim të Senatit Akademik, bazuar në politikat sociale të AU-së, miraton kategoritë e studentëve që do të përfitojnë bursa të ndryshme studimi dhe kriteret, të cilat duhet të përmbushë studenti për t'u bërë pjesë e "Programit të Ekselencës" për çdo vit akademik;
- q. miraton rregulloren e funksionimit të tij.
5. Anëtarësia në Bordin e Administrimit është e papajtueshme me detyrën e Rektorit, të Dekanëve, të Drejtuesit të Departamentit, të Administratorit të Përgjithshëm dhe të Administratorëve të fakulteteve.
6. Mandati i anëtarit të Bordit të Administrimit përfundon:
- me mbarimin e afatit;
  - me dhënien e dorëheqjes;
  - me largimin nga AU-ja;
  - me mungesën pa arsye në 3 (tre) mbledhje radhazi;
  - në rastet paafërsie fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
  - në rastin e shkeljeve të rënda të ligjit;
  - me propozim të Administratorit të shoqërisë tregtare, për anëtarët e emëruar nga ai;
  - kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që çënon rëndë personalitetin dhe integritetin e tij dhe që lidhet ngushtë me ushtrimin e këtij funksioni.

### Neni 33

#### Administratori i Përgjithshëm

- Administratori i Përgjithshëm është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësuesi ligjor i institucionit për çështjet financiare dhe administrative të universitetit.
- Administratori i Përgjithshëm është përgjegjës për mirëfunksionimin administrativ dhe financiar të AU-së.
- Administratori i Përgjithshëm i AU-së propozohet nga Administratori i shoqërisë tregtare dhe emërohet nga Bordi i Administrimit.
- Administratori i Përgjithshëm i AU-së, duhet të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin "Master i Shkencave" në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune së paku 7 (shtatë) vjet në këto fusha.
- Administratori i Përgjithshëm i AU-së nuk mund të ushtrorë asnjë funksion tjetër akademik apo administrativ.
- Administratori i Përgjithshëm kryen këto funksione:
  - harton projektbuxhetin vjetor, në bashkëpunim me zyrën e financës dhe me Rektoratin, mbi bazën e propozimeve të fakulteteve dhe departamenteve, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij;
  - i propozon Bordit të Administrimit kriteret për hartimin e projektbuxhetit vjetor dhe atij afatmesëm, dhe rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron AU-ja nga asistimi dhe veprimtarive të saj, dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
  - ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të AU-së;





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

- d. zbaton të gjitha vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik me karakter financiar dhe administrativ;
  - e. harton në bashkëpunim me Rektoratin dhe zyrën e financës raportin vjetor mbi veprimtarinë financiare të AU-së, konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe ia paraqet Bordit të Administrimit për miratim;
  - f. bashkëpunon me strukturat dhe autoritetet e tjera të AU-së për çështje të administrimit të përditshëm;
  - g. emëron dhe shkarkon administratorët e fakulteteve dhe personelin administrativ pas miratimit të Bordit të Administrimit;
  - h. plotëson kërkesat e Rektorit, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
  - i. raporton për veprimtarinë e tij pranë Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik.
7. Funksione të tjera të Administratorit përcaktohen në Statut dhe në Rregulloren e Përgjithshme të AU-së dhe në Rregulloren e Bordit të Administrimit.

### Neni 34

#### Administratori i Njesisë Kryesore/Fakultetit

1. Administratori i Fakultetit është përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të fakultetit dhe ka varësi direkt nga Administratori i Përgjithshëm.
2. Administratori i Fakultetit propozohet nga Administratori i Përgjithshëm dhe emërohet nga Bordi i Administrimit.
3. Administratori i njesisë kryesore duhet të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin "Master i Shkencave" në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune së paku 5 (pesë) vjet në këto fusha.
4. Administratori i njesisë kryesore nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ.
5. Funksionet e Administratorit të Fakultetit janë:
  - a. realizon administrimin e përditshëm financiar të fakultetit, duke bashkëpunuar ngushtë me zyrën e financës;
  - b. mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë financiare të fakultetit;
  - c. i raporton për veprimtarinë e tij Administratorit të Përgjithshëm të AU-së dhe informon Dekanin, sipas përcaktimeve në Rregulloren e Fakultetit;
  - d. ndjek udhëzimet e Administratorit të Përgjithshëm dhe Dekanit;
  - e. plotëson kërkesat e drejtuesit të njesisë kryesore, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
  - f. përgjigjet për plotësimin në kohë të kërkesave të njesisë akademike e njesisë të tjera për materiale, kancelari e shërbime;
  - g. mbikëqyr ambientet e godinës, sallat, ndarjen e klasave sipas orarit të mësimtarëve nga Dekani;
  - h. administron lejet higjiëno-sanitare të godinës dhe librezat higjiëno-sanitare të stafit, aktet kundër zjarrit të godinës;





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

- i. Administratori i njësisë bazë mban marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me të gjitha strukturat bazë të fakultetit;
  - j. raporton në mënyrë periodike për detyrat që i janë ngarkuar pranë Administratorit të Përgjithshëm të AU-së.
6. Funkcionet e Administratorit të Fakultetit bazuar në Statut përcaktohen dhe në Rregulloret e Fakultetit.

### Neni 35

#### Kryesekretari i Njësisë Kryesore/Fakultetit

7. Kryesekretari i Fakultetit është personel ndihmës akademik me karakter administrativ në varësi të Administratorit të Përgjithshëm dhe përgjigjet për drejtimin dhe veprimtarinë e sekretarisë mësimore.
8. Funkcionet e Kryesekretarit të Fakultetit janë:
  - a. është përgjegjës për regjistrimin dhe matrikullimin e studentëve, krijimin, sistemimin dhe mbajtjen konfidenciale të të dhënave të tyre;
  - b. përgatitja për vendimmarrje e dokumentacionit të studentëve për aplikim, regjistrim, transferim, pezullim, ndërprerje, çregjistrim dhe rifillim të studimeve;
  - c. është përgjegjës për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve të studentëve;
  - d. kontrollon dhe nënshkruan dokumentacionin e lëshuar nga sekretaria mësimore e fakultetit përkatës;
  - e. përpilon statistika të ndryshme rreth studentëve.
9. Funksione të tjera të Kryesekretarit të Fakultetit përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme, Rregulloren e Sekretarisë dhe në Rregulloren e Fakultetit.

### Neni 36

#### Njësitë administrative

1. Në funksion të plotësimi të nevojave të njësive mësimore-shkencore e detyrimeve ligjore dhe fiskale të universitetit si institucion jopublik, AU-ja ka këto njësi administrative:
  - a) Zyra e Financës;
    - Njësia e Auditit të Brendshëm.
  - b) Zyra e Burimeve Njerëzore;
  - c) Zyra e Informacionit;
  - d) Zyra e Arshivës dhe Protokollit;
  - e) Zyra e IT-së.
2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të këtyre njësive është në kompetencë të Bordit të Administrimit. Veprimtaria e këtyre njësive rregullohet me rregullore të veçanta që miratohen nga Bordi i Administrimit.

### Neni 37

#### Njësitë ndihmëse dhe të shërbimit në AU

1. AU-ja ka këto njësi ndihmëse dhe shërbimi:





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

- a) Sekretarinë mësimore;
  - b) Bibliotekat universitare;
  - c) Laboratorët;
  - d) Klinika Stomatologjike Universitare "Çerçiz Mingomataj";
  - e) Klinika Fizioterapeutike Universitare;
  - f) Klinika Stomatologjike "UFO";
  - g) Shtëpia botuese "Albanian University Press";
  - h) Klinika e ligjit.
2. Secila nga këto njësi ka strukturën e saj dhe ushtron veprimtari sipas përcaktimeve në rregulloret e veçanta për organizimin dhe funksionimin e tyre, që miratohen nga Senati Akademik i AU-së.
3. Në varësi të nevojave që mund të lindin, AU-ja ka të drejtën e krijimit të njësive të tjera ndihmëse dhe shërbimi, me propozim të Senatit Akademik dhe miratim të Bordit të Administrimit.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

### KREU III PERSONELI

#### Neni 38 Personeli në AU

1. Personeli në AU përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës-akademik dhe personeli administrativ.
2. Personeli mund të jetë i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme.

#### Neni 39

##### Kategoritë e personelit akademik në AU

1. Personeli akademik në AU kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të institucionit, këshillim për studentët, si dhe veprimtari të tjera.
2. Personeli akademik në AU është me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor. Raportet ndërmjet veprimtarive të ndryshme janë pjesë e kontratës individuale të punës mes palëve.
3. Personeli akademik sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në: (a) Profesorë; (b) Lektorë; dhe (c) Asistent-lektorë.
  - a) "Profesorë" janë anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie kanë titujt akademik "Profesor" ose "Profesor i asociuar".
  - b) "Lektorë" janë anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë kategori përfshihen anëtarët e personelit akademik që mbajnë gradën shkencore "Doktor", kanë së paku tre vite eksperiencë në mësimdhënie dhe përbushin kriteret e përcaktuara në Statut.
  - c) "Asistent-lektorë" janë anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore. Asistent-lektorët duhet të kenë së paku diplomën "Master i Shkencave".
4. Numri i përgjithshëm i personelit në AU propozohet nga Senati Akademik dhe miratohet nga Bordi i Administrimit, sipas përcaktimeve në këtë Statut.

#### Neni 40

##### Punësimi i personelit akademik

1. Në fillim të çdo viti akademik, bazuar në nevojat për personel akademik, njësitë bazë të fakultetit përkatës i paraqesin Dekanit të fakultetit kërkesat për plotësimin e vendeve vakante. Dekanati i fakultetit i'a përcjell këto kërkesa Rektoratit i cili miraton kriteret e pranimit dhe procedurat e konkurrimit të propozuara nga njësitë bazë.
2. Punësimi i personelit akademik bëhet me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, bazuar në aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, si dhe legjisllacionin që rregullon marrëdhëniet e punës.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

3. Marrëdhëniet e punësimit të personelit akademik të AU-së rregullohen përmes kontratës individuale të punës, ku janë të përcaktuara të drejtat dhe detyrimet bazuar në legjislacionin e punës dhe atë të arsimit të lartë në fuqi.
4. Vendet e punës për personelin akademik fitohen nëpërmjet një procedurë konkurrimi.
5. Për të drejtuar procedurat e konkurrimit ngrihet një Komision Ad Hoc, i cili përbëhet nga Zv. Rektori për Procesin Mësimor, Dekani, Drejtuesi i Departamentit, një anëtar i Asamblesë së Personelit Akademik me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie dhe i fushës përkatëse, i propozuar nga Drejtuesi i Departamentit si dhe, një përfaqësues i Burimeve Njerëzore.
6. Punësimi realizohet me procedurë të konkurrimit të hapur përmes një procesi transparent, të paanshëm dhe objektiv. Universiteti përcakton kriteret e përgjithshme që kandidatët konkurrues duhet të përmbushin si më poshtë:
  - a. diplomimi përkatës;
  - b. formimi i përgjithshëm arsimor dhe profesional;
  - c. kualifikime të tjera (gradat shkencore ose titujt akademikë);
  - d. zotërimi i aftësive të nevojshme personale për vendin e punës;
  - e. të ketë eksperiencë në mësimdhënie dhe eksperiencë profesionale, e lidhur me lëndën që do të mbulojnë;
  - f. preferohet që aplikantët të kenë gradën shkencore "Doktor", "Prof.Asoc" "Prof.Dr.";
  - g. të zotërojnë aftësitë e nevojshme personale për vendin e punës, si aftësi komunikimi;
  - h. të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje.
7. Universiteti ka të drejtë për të vendosur kriteret e veçanta sipas pozicionit dhe përshkrimit të punës bazuar te kriteret e përgjithshme të këtij Statuti.
8. Komisioni i Vlerësimit pasi shqyrton kandidaturat i propozon Dekanit për miratim kandidatët e përzgjedhur ku përparësi u jepet kandidatëve që plotësojnë më mirë kriteret dhe i përgjigjen përshkrimit të vendit të punës.
9. Pasi struktura përkatëse e universitetit ka shpallur kandidatin fitues nga përzgjedhja, kandidati fitues nënshkruan kontratën e punës e cila nënshkruhet nga Rektori dhe i punësuar.
10. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë nuk mund të jetë i punësuar si personel akademik me kohë të plotë në një institucion tjetër të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit.
11. Kandidati i përzgjedhur i nënshtrohet një periudhe prove deri në 3 (tre) muaj në mbarim të së cilës përcaktohet nëse marrëdhënia e punës do të vazhdojë apo do të ndërpritet.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

### Neni 41

#### Personeli akademik i ftuar

1. Për mirëfunktionimin e procesit mësimor, departamentet kanë të drejtë të kërkojnë të punësojnë me kontratë për periudha të caktuara kohe studiuës dhe/ose personalitete vendase ose të huaj, në fushat respektive të studimit në AU.
2. Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar duhet të kombinojë nevojën e njesisë për mësimdhënie ose kërkim shkencor me kualifikimet e tyre.
3. Personeli akademik i ftuar zgjidhet nga lista e personave që propozohen në departamentin përkatës duke pasur parasysh formimin e tyre akademik apo përvojën profesionale në një fushë të caktuar, që u shërben nevojave konkrete të mësimdhënies ose kërkimit shkencor.
4. Personeli i ftuar propozohet nga drejtuesi i njesisë bazë dhe miratohet nga drejtuesi i njesisë kryesore.
5. Kriete të detajuara për aktivizimin dhe përzgjedhjen e personelit akademik të ftuar përcaktohen në këtë Statut si dhe në Rregulloren e Përgjithshme të AU-së. Shpenzimet për këtë kategori përballohen nga të ardhurat e fakultetit.
6. Personeli akademik i ftuar punësohet sipas procedurave të nenit 40.

### Neni 42

#### Kohëzgjatja e punësimit të personelit akademik

1. Personeli akademik, që mban titullin "Profesor", shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç, me përjashtim të rastit kur, me kërkesën e tij, largohet nga detyra. Mbështetur mbi nevojat e AU-së dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë si personel akademik edhe pas moshës së lartpërmendur, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit, të përsëritshme.
2. Personeli akademik, që mban titullin "Profesor i asociuar", shërben në detyrë deri në moshën 65 vjeç. Mbështetur mbi nevojat e AU-së dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë si personel akademik edhe pas moshës së lartpërmendur, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit, të përsëritshme.
3. Personeli akademik i kategorisë "Profesor" mund të shkëputet përkohësisht nga institucioni i arsimit të lartë, për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh, për t'u angazhuar në detyra të rëndësishme shtetërore dhe politike. Për periudhën e shkëputjes mund të zëvendësohet nga personel akademik i punësuar me kontratë me afat të caktuar. Pas përfundimit të detyrës, me kërkesë të tij, anëtar i personelit akademik rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend të barasvlershëm.

### Neni 43

#### Viti akademik sabatik

1. Personelit akademik të kategorisë "Profesor" dhe "Lektor" i takon e drejta e vitit akademik sabatik një herë në shtatë vjet, për një periudhë kohe deri në një vit, me miratim të departamentit dhe fakultetit për të punuar për përparimin e tij akademik.
2. Kandidati/ja paraqet në departament projektin e tij/saj për kërkimin shkencor që do të realizojë dhe periudhën gjatë së cilës ai/ajo do të ushtrojë të drejtën e vitit sabatik. Departamenti shpreh miratimin e tij dhe njofton drejtuesin e njesisë kryesore dhe Rrekturin e AU-së.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

3. Gjatë kësaj periudhe personeli akademik nuk ngarkohet me mësimdhënie;
4. Marrëdhëniet juridike midis palëve gjatë vitit akademik sabatik do të parashikohen në urdhrin e miratimit të kërkesës së personelit akademik. Gjithashtu në këtë urdhrë do të parashikohet pagesa që përfiton personeli akademik gjatë vitit sabatik si dhe përgjegjësitë në rast mosrealizimit të projektit të propozuar dhe kohës së miratuar referuar urdhrin të miratimit të kërkesës.
5. Në përfundim të vitit akademik sabatik, punonjësi akademik paraqet në departament raportin përfundimtar të aktivitetit të kryer.

### Neni 44

#### Ngarkesa mësimore

AU, në përcaktimin e ngarkesës vjetore mësimore dhe të veprimtarisë kërkimore-shkencore për çdo kategori të personelit akademik, respekton kriteret ligjore të vendosura nga ministria përgjegjëse për arsim, sipas nevojave të departamenteve.

### Neni 45

#### Personeli ndihmës-akademik

1. Personeli ndihmës-akademik përbëhet nga:
  - a) personeli ndihmës-akademik me karakter mësimor;
  - b) personeli ndihmës-akademik me karakter administrativ.
2. Marrëdhëniet e tyre të punës rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit të punës në fuqi.

### Neni 46

#### Personeli ndihmës-akademik me karakter mësimor

1. Personeli ndihmës-akademik me karakter mësimor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor. Ai është pjesë e departamentit dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të këtij të fundit.
2. Në kategorinë e këtij personeli bëjnë pjesë: laborantët, asistentët e departamenteve dhe asistent pedagogët për praktikat mësimore, sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Përgjithshme të AU-së.

### Neni 47

#### Personeli ndihmës-akademik me karakter administrativ

1. Personeli ndihmës-akademik me karakter administrativ në AU ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë në nivel Institucional, nivel fakulteti dhe nivel departamenti.
2. Në këtë kategori bëjnë pjesë personeli i sekretarisë mësimore, sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Përgjithshme të AU-së.





STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY  
KREU IV  
ORGANIZIMI I STUDIMEVE DHE TITUJT

Neni 48

Format e studimit

1. Format e studimeve që AU mund të ofrojë janë:
  - a. studime me kohë të plotë;
  - b. studime me kohë të zgjatur.
2. Realizimi i secilës nga format e mësipërme të studimit bëhet sipas propozimit të AU-së, me miratim të ministrisë përgjegjëse për arsim, në përputhje me kuadrin ligjor për arsimin e lartë në Shqipëri.

Neni 49

Programet e studimeve dhe titujt e diplomave të studimit

1. AU mund të ofrojë programe studimi të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), si më poshtë:
  - a. programe me karakter profesional, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Këto programe ofrohen për kandidatë për studentë pas përfundimit të arsimit të mesëm. Ato realizohen me 60 ose 120 kredite evropiane (ECTS). Kohëzgjatja e tyre normale është një ose dy vite akademike dhe në përfundim lëshohet respektivisht "Certifikatë profesionale" ose "Diplomë profesionale" në fushën e arsimimit të kryer.
  - b. programe të ciklit të parë "Bachelor", referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Këto programe organizohen me 180 kredite ECTS dhe kohëzgjatja normale e tyre është tre vite akademike. Në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diploma "Bachelor" në fushën e arsimimit të kryer.
  - c. programe të ciklit të dytë, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: "Master i Shkencave" dhe "Master Profesional". Programet "Master i Shkencave" pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si dhe me aftësimin për kërkim shkencor në një fushë të caktuar.

Ato organizohen në:

- programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë, të cilat realizohen me 300 dhe 360 kredite ECTS dhe me kohëzgjatje normale respektive pesë dhe gjashtë vite akademike. Në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master i Shkencave" në fushën e arsimimit të kryer;
  - programe që realizohen me 120 kredite ECTS në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike. Në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master i Shkencave" në fushën e arsimimit të kryer. Programet "Master Profesional" pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar dhe organizohen me 60 ose 120 kredite ECTS, me kohëzgjatje normale një ose dy vite akademike. Në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master Profesional" në fushën e arsimimit të kryer.
- d. Programe të ciklit të tretë, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

- specializime afatgjata - janë programe të formimit profesional që ofrojnë njohuri për profesione të veçanta. Ato zgjasin jo më pak se 2 vite akademike dhe organizohen me jo më pak se 120 kredite ECTS. Në përfundim të tyre lëshohet "Diplomë specializimi" në fushën përkatëse të programit të studimit;
  - doktoratë - studimet e doktoratës organizohen në fusha/nënfusha kërkimi, të cilat përmbajnë veprimtari kërkimore-shkencore, me qëllim garantimin e formimit në fushën/nënfushën përkatëse të studimit. Në bazë të projekteve kërkimore-shkencore, departamenti përgjegjës, përcakton numrin e studentëve doktorantë në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe certifikimin e kapaciteteve akademike e infrastrukurore nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore "Doktor".
- e. Programe të përbashkëta të studimit, të cilat realizohen nga AU-ja në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose jopublike, brenda ose jashtë vendit, dhe realizohen në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar dhe legjislationin në fuqi. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët, diplomë e dyfishtë ose e shumëfishtë. Në kushtet e realizimit të programeve të përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë mund të zbatohen standarde të ndryshme nga ato shtetërore.
- f. Programe studimi të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë të gjithë jetës. Këto programe shërbejnë për plotësim, thellim e konsolidim të njohurive dhe mund të ofrohen si kurse kualifikimi e rikualifikimi, shkolla verore dhe veprimtari të ngjashme. Studimet e formimit të vazhduar, kohëzgjatja, kreditet dhe lloji i diplomës/certifikatës përcaktohen në çdo rast nga departamenti përgjegjës.
3. Mënyra e organizimit të çdo programi studimi, përcaktohet në Rregulloren e Fakultetit dhe departamentit, ndërsa përmbajtja e tyre në rregulloren përkatëse të çdo programi studimi.
  4. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite (ECTS).
  5. Programet e studimeve universitare hartohen nga departamenti dhe miratohen në Senatin Akademik të AU-së. Ato hartohen në përputhje me kërkesat e legjislationit në fuqi, standardeve të parashikuara në Kodin e Cilësisë të Arsimit të Lartë, duke marrë në konsideratë kërkesat e tregut të punës dhe punësimin e ardhshëm të studentëve.
  6. Programet e studimeve të ofruara nga AU shpallen publikisht para fillimit të aplikimeve për pranimin e studentëve.

### Neni 50

#### Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies

1. Studimet universitare në AU zhvillohen me bazë vitin akademik.
2. Data e fillimit të vitit akademik shpallet nga ministri përgjegjës për arsimin.
3. Viti akademik organizohet në dy semestra. Çdo semestër ka 15 (pesëmbëdhjetë) javë mësimore.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

4. Ngarkesa mësimore javore në auditor përcaktohet mbi bazën e akteve nënligjore në fuqi. Shpërndarja e komponentëve mësimorë përcaktohet në planin mësimor të çdo programi studimi.
5. Frekuentimi i procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimdhënëse në auditor dhe ciklit të studimit, është i detyrueshëm në një masë të caktuar. Në këtë drejtim, AU respekton standardet e përcaktuara në Kodin e Cilësisë dhe udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin, të cilat pasqyrohen në mënyrë të hollësishme në Rregulloren e Përgjithshme të AU-së dhe në rregulloret e veçanta të çdo programi studimi.

### Neni 51

#### Pranimet në ciklin e parë, ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve

1. Pranimi i studentëve në cikle të ndryshme të studimit në AU bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. AU mund të përcaktojë kriteret e veçanta për përzgjedhjet e kandidatëve për t'u pranuar në çdo program studimi të ofruar prej tij. Këto kriteret i përcillen ministrisë përgjegjëse për arsimin.
3. Kuotat për çdo program studimi miratohen nga Senati Akademik dhe i përcillen për miratim ministrisë përgjegjëse për arsimin.
4. Për pranimin e studentëve në programet e studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" dhe ciklit të tretë kërkohet nga kandidati edhe njohja e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, ose spanjisht. Niveli i gjuhës së huaj dhe testet ndërkombëtare, përcaktohen me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

### Neni 52

#### Kodifikimi i programeve të studimit

Kodifikimi i programeve të studimit në AU, bëhet nga ministria përgjegjëse për arsimin, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Neni 53

#### Gjuha e studimeve

1. Gjuha e studimit të programeve të studimit të ofruara nga AU, është gjuha shqipe.
2. Programe studimi mund të ofrohen edhe në një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian, të miratuar në aktin përkatës të hapjes së programit të studimit nga ministria përgjegjëse për arsimin.
3. Studentët e AU-së që regjistrohen në një program studimi në gjuhë të huaj, duhet të dëshmojnë njohjen e gjuhës së huaj përkatëse në nivelin e nevojshëm për të kryer studime të larta, të përcaktuar nga institucioni në rregulloren e këtij programi studimi.

### Neni 54

#### Kohëzgjatja e studimeve

1. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

2. Studenti që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Ai i nënshtrohet kritereve dhe procedurave të shpallura për regjistrim në AU.
3. Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen me vendim të komisionit të transferimeve në AU, që pranon studentin, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e tij.

### Neni 55

#### Transferimi i studimeve

1. AU ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve të studentëve midis programeve të të njëjtit cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta, vetëm në fillim të vitit akademik.
2. AU ofron njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve brenda institucionit dhe nga institucione të tjera të vendit dhe të huaja.
3. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimit të studimeve përcaktohen në Rregulloret e Departamenteve, dhe në mënyrë të hollësishme në Rregulloren e Regjistrimeve dhe Transferimeve.

### Neni 56

#### Ndjekja e një programi të dytë studimi

1. Të drejtën për të ndjekur një program të dytë studimi, e kanë të gjithë ata studentë, të cilët kanë përfunduar dhe janë diplomuar në një program studimi.
2. Kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve përcaktohen nga njësia bazë ofruese e programit. Bëjnë përjashtim nga ky rregull programet e integruara të studimit. Kriteret miratohen sipas përcaktimeve në Statutin e AU-së dhe bëhen publike nga njësia kryesore dhe QSHA-ja.
3. Kriter kryesor pranimi në një program studimi të ciklit të dytë "Master i Shkencave" është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individ i ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.
4. Të gjithë kandidatët, të cilët kërkojnë të ndjekin ciklin e dytë të studimeve në AU, duhet të kryejnë procesin e aplikimit nëpërmjet dorëzimit të dokumentacionit pranë zyrës përkatëse në AU.
5. Aplikimi kryhet nga kandidatët të cilët:
  - a) kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomë për ciklin e parë të studimeve;
  - b) zotërojnë dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor;
  - c) nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, në IAL të publike ose jopublike;
  - d) plotësojnë kriteret e përcaktuara nga AU-ja për programet e studimit për të cilat aplikojnë.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

6. Njësitë bazë të AU-së, pas kryerjes së aplikimit nga kandidatët për ciklin e dytë të studimeve, në bazë të kriterëve ligjore dhe kuotave të përcaktuara rendisin kandidatët fitues.
7. Listat e fituesve shpallen dhe afishohen, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse të arsimit, në mjedise publike si dhe në faqen zyrtare të universitetit. Fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.
8. Sekretaria mësimore e AU-së pranon dokumentacionin për të gjithë kandidatët fitues.

### Neni 57

#### Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe suplementit të diplomës

1. Studenti në përfundim të një programi studimi në AU pajiset me diplomën ose certifikatën përkatëse.
2. Çdo formë diplome dhe certifikate përpara se të lëshohet, regjistrohet përkatësisht në regjistrin shtetëror të diplomave ose regjistrin shtetëror të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.
3. AU-ja nuk mund të lëshojë dublikatë diplome, por mund të lëshojë dokument të barasvlershëm me diplomën në formën e vërtetimit, i cili duhet të përmbajë: emrin e institucionit që ka lëshuar diplomën, numrin e diplomës origjinale, datën e lëshimit të saj, ciklin dhe programin e studimit.
4. Diplomat e AU-së shoqërohen edhe me suplementin e diplomës. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e HEAL dhe legjislacionit në fuqi.
5. Diploma dhe suplementi i diplomës firmosen nga Dekani dhe Rektori.



*[Handwritten signature]*



## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

### KREU V KËRKIMI SHKENCOR

#### Neni 58

##### Struktura e kërkimit shkencor

1. AU-ja kryen veprimtari kërkimore-shkencore, studime, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese sipas natyrës dhe objektivave specifike të fakulteteve.
2. Për zhvillimin dhe organizimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në AU, funksionojnë strukturat e mëposhtme:
  - a) Komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor dhe botimin;
  - b) Zyra e koordinimit të kërkimit shkencor dhe botimeve akademike.

#### Neni 59

##### Veprimtaria kërkimore-shkencore

1. AU-ja synon që nëpërmjet veprimtarive kërkimore-shkencore të rrisë shkallën e kualifikimit të personelit të tij akademik dhe të aftësojë studentët për kërkime të pavarura, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm profesional dhe karrierës akademike.
2. Veprimtaritë kërkimore-shkencore realizohen mbi bazën e planit strategjik për kërkimin shkencor të AU-së.
3. AU-ja synon që nëpërmjet veprimtarive kërkimore-shkencore të ofrojë shërbime për të tretë.
4. AU-ja ka të drejtë të hartojë programe dhe projekte kërkimore në bashkëpunim me institucione të tjera publike ose private, brenda dhe jashtë vendit.
5. Veprimtaria kërkimore-shkencore është pjesë e planit të punës të çdo njësie përbërëse në AU.
6. Në fillim të çdo viti akademik, stafi akademik ka detyrimin e planifikimit dhe të raportimit periodik të veprimtarisë shkencore, në funksion të kërkimit shkencor.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

### KREU VI STUDENTI DHE TË DHËNAT PËR STUDENTËT

#### Neni 60

##### Statusi i studentit

1. Statusi i studentit fitohet me regjistrimin në AU dhe humbet me marrjen e diplomës ose certifikatës përkatëse, si edhe në rastin e çregjistrimit të tij nga AU-ja.
2. Studenti nuk mund të regjistrohet njëkohësisht në më shumë se një program studimi. Bëjnë përjashtim nga ky rregull, studentët e shkëlqyer me notë mesatare maksimale nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë.
3. Studenti ka të drejtë që të kërkojë pezullimin dhe rifillimin e studimeve të tij, në përputhje me rregullat e parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të AU-së dhe në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore.

#### Neni 61

##### Të drejtat e studentëve

1. Studentët në AU kanë të drejtat si më poshtë:
  - a. të marrin pjesë në vendimmarrje nëpërmjet përfaqësimit në strukturat e specifikuar në këtë Statut dhe rregulloret e tjera të AU-së;
  - b. të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit të AU;
  - c. të ndjekin të gjitha veprimtaritë mësimore dhe shkencore, të organizuara në kuadër të programit të studimit ku janë regjistruar;
  - d. të përdorin infrastrukturën që AU-ja vë në dispozicion të procesit mësimor, si dhe të përfitojnë nga shërbimet mbështetëse që ofrohen për studentët në AU;
  - e. të nënshkruajnë kontratën e studimit në momentin e regjistrimit në AU. Elementet e kontratës dhe forma e saj përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin;
  - f. të pajisen nga AU-ja me Kartën e Studentit, që është dokument unik. Kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsim;
  - g. të përfitojnë bursë studimi ose reduktim të tarifës, kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Bordi i Administrimit dhe Senati Akademik;
  - h. për studentët që studiojnë në programet e studimit në Albanian University, realizohet sigurimi në një ndër shoqëritë e sigurimit, për risqe që mund të vijnë për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të programit përkatës të studimit.

#### Neni 62

##### Detyrimet e studentit

1. Studentët në AU kanë për detyrë:
  - a. të zbatojnë rregullat e parashikuara në Statut dhe në rregulloret e AU-ja;
  - b. të paguajnë tarifat e shkollimeve dhe të shërbimeve që u ofron AU-ja;
  - c. të respektojnë Kodin e Etikës së AU-së;
  - d. të respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

2. AU-ja nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e detyrimeve nga studenti.

### Neni 63

#### Këshilli Studentor

1. Këshilli Studentor është një organizëm i pavarur i studentëve të AU-së, i cili nuk zhvillon aktivitet politik dhe ekonomik.
2. Ky këshill promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të AU-së, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve.
3. Këshilli Studentor zgjidhet çdo vit nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi.
4. Këshilli Studentor nuk ka të drejtë të organizohen me struktura të tjera politike e jopolitike, jashtë AU-së.
5. Modalitetet dhe procedurat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e tij përcaktohen në këtë Statut si dhe në Rregulloren e Brendshme të këtij Këshilli, e cila hartohet në përputhje me këtë Statut dhe Ligjin Nr. 80/2015 mbështetur edhe në propozimet e paraqitura nga studentët.
6. Këshilli Studentor shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të AU-së, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, menaxhimin e shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj.
7. AU mbështet Këshillin Studentor dhe financon veprimtari të tij.

### Neni 63/1

#### Krijimi, organizimi dhe funksionimi i Këshillave Studentorë

1. Këshilli Studentor i "Albanian University" ka këto qëllime dhe objektiva kryesore:
  - a. të trajtojë shqetësimet e studentëve dhe të veprojë për zgjidhjen e tyre;
  - b. të kontribuojë në rritjen e aftësive organizuese dhe administruese të grupeve më aktive të studentëve;
  - c. të krijojë struktura që shërbejnë për informimin e studentëve dhe të kujdeset për mbarëvajtjen e tyre;
  - d. të bashkëpunojë me organet drejtuese të universitetit dhe të fakulteteve me synim përmirësimin e nivelit mësimor e kërkimor-shkencor;
  - e. të ndërmarrë veprime që do të ndihmojnë në përmirësimin e gjendjes së studentëve;
  - f. të krijojë struktura ndihmëse në zhvillimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare për studentët;
  - g. të ofrojë shërbime lehtësuese për studentët;
  - h. të zhvillojë nivelin kulturor dhe arsimor të studentëve;





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

- i. të kryejë aktivitete që synojnë argëtimin në format e tij më të larmishme.
2. Organizimi dhe organet drejtuese të Këshillit Studentor janë si më poshtë:
  - Kryesia: Kryetari, Zv/Kryetari dhe Koordinatorët;
  - Sekretari i përgjithshëm;
  - Senati Studentor.
3. Organet drejtuese të Këshillave Studentorë të fakulteteve të Albanian University janë:
  - a. Mbledhja e Koordinatorëve - organi më i lartë vendimmarrës. Anëtarë të mbledhjes së Senatorëve janë senatorët e zgjedhur drejtpërdrejt nga trupa zgjedhore sipas përcaktimeve në Rregulloren e Zgjedhjeve, pjesë e Këshillit Studentor, që mblidhet nga kryetaret;
  - b. Organe të tjera mund të krijohen me vendim të mbledhjes së këshillit dhe autoriteteve drejtuese të Albanian University;
4. Zgjedhjet për këshillin studentor të Albanian University, procedurat dhe modalitetet e mbajtjes së tyre përcaktohen si më poshtë vijon:
  - a. të gjithë senatorët e Albanian University kanë të drejtë vote në zgjedhjet për anëtarët e KSAU;
  - b. Të gjithë studentët e Albanian University, të cilët nuk janë nën masa të veçanta akademike (me kusht, pezullimi) në kohën e zgjedhjeve kanë të drejtë për të konkurruar për Senatin Studentor të KSAU.
  - c. Të gjithë studentët e Albanian University të cilët gjatë viteve akademike para zgjedhjeve kanë një mesatare 8 dhe nuk janë nën masa të veçanta akademike (me kusht, pezullimi) në kohën e zgjedhjeve kanë të drejtë për të konkurruar për kryesinë e KSAU.
  - d. Të gjithë studentët janë të garantuar në mënyrë që të bëjnë zgjedhjen e tyre dhe të zhvillohen zgjedhje të lira e të rregullta mes kandidatëve për KSAU.
5. Në funksionimin e këshillit studentor të Albanian University aplikohen parimet e bashkëpunimit si dhe të respektit të ndërsjellë. KSAU nuk zhvillon veprimtari politike dhe ekonomike. Ky këshill është një organizëm jo politik, të cilit i ndalohet çdo lloj bashkëpunimi me parti politike dhe organizata politike. Të gjithë anëtarëve u ndalohet shfaqja politike publike, në emër të KSAU.

### Neni 64

Dokumentacioni i procesit mësimor në funksion të studentëve

1. Në AU mbahet në formë të shkruar dhe elektronike dokumentacioni si më poshtë vijon:






## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

- a. *regjistri themeltar i studentëve* - është dokumenti që vërteton regjistrimin e studentëve në AU, ku çdo student pajiset me një numër unik matricullimi, që e mban deri në marrjen e diplomës ose certifikatës, i cili pasqyrohet në këtë regjistër;
  - b. *regjistri i arritjeve akademike* - është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga çdo student i regjistruar në AU, për çdo program studimi;
  - c. *regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave* - është dokumenti që vërteton lëshimin e tyre nga AU-ja, ku vërtetohet se çdo student ka tërhequr diplomën dhe suplementin e saj, në përputhje me titullin e arritur, pasi ai ka përfunduar me sukses detyrimet akademike dhe detyrimet e tjera institucionale.
2. AU ka detyrimin ligjor që të tre këto regjistra të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, pas plotësimit përfundimtar të tyre t'i depozitojë në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njehsuar me origjinalin ruhet në arkivin e AU-së për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së institucionit.
  3. Këto regjistra shpërndahen nga ministria përgjegjëse për arsim.

### Neni 65

#### Baza e të dhënave të studentëve në AU

1. AU-ja ruan të dhënat personale të studentëve.
2. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga AU-ja, kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

### KREU VII SIGURIMI I CILËSISË

#### Neni 66

##### Struktura e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

1. AU-ja është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha njësitë përbërëse të saj.
2. Pranë AU-së, ngrihet dhe funksionon "Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë" i cili është vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të institucionit i cili realizohet nga strukturat si më poshtë:
  - a) Komisioni për Vlerësimin Institucional, parashikuar në nenin 23 të këtij Statuti;
  - b) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

#### Neni 67

##### Veprimtaria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

1. Strukturat e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë përgjegjëse për ngritjen, funksionimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të brendshëm të cilësisë në AU dhe vlerësojnë periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore.
2. Në veprimtarinë e tyre, këto struktura ushtrojnë si funksione kryesore:
  - a. zbatimin e standardeve të sigurimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Cilësisë;
  - b. planifikimin dhe organizimin periodik të vlerësimit të brendshëm të cilësisë të programeve të studimit dhe vlerësimit të brendshëm institucional;
  - c. ndjekjen dhe monitorimin e proceseve të akreditimit, rankimit dhe çdo procedure tjetër të vlerësimit të zhvillimit të aktivitetit akademik të AU-së, të cilat kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi;
  - d. organizimin e pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe për lëndët e çdo programi studimi, në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve;
  - e. realizimin e studimeve gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga AU-ja, në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumnit.
3. Mënyra e organizimit të vlerësimit të brendshëm, aktivitetet që kryhen, përgjegjësitë dhe funksione të tjera të detajuara të strukturave të sistemit të brendshëm të cilësisë përcaktohen në këtë Statut si dhe në Rregulloren për Sigurimin e Sistemit të Cilësisë në Albanian University.

#### Neni 68

##### Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

1. NJSBC-ja e zhvillon veprimtarinë e saj në kuadër të "Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë" në AU. Universiteti bazuar në Statutin e tij nëpërmjet Njësies së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) realizon vlerësimin dhe kontrollin e cilësisë së aktivitetit akademik, duke bashkëpunuar me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimit dhe Shkencave (ASCAL)





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 80/2015 dhe akte të tjera nënligjore të dala në zbatim të ligjit të mësipërm.

2. NJSBC-ja është përgjegjëse për proceset e akreditimit, rankimit dhe çdo procedure tjetër të vlerësimit të zhvillimit të aktivitetit akademik të universitetit të cilat kryhen në afatet e përcaktuara në ligj apo akte nënligjore.
3. NJSBC-ja siguron drejtimin, këshillimin dhe mbështetjen për hartimin dhe zbatimin e procedurave të brendshme të sigurimit të cilësisë në përputhje me ligjin, aktet nënligjore, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit.
4. NJSBC-ja ka varësi të drejtpërdrejtë nga Komisioni për Vlerësimin Institucional, sipas Statutit të AU-së (neni 23) dhe raporton tek ai në mënyrë periodike lidhur me detyrat e ngarkuara dhe situatën e cilësisë së veprimtarive akademike universitare.
5. NJSBC-ja ka rol mbështetës, këshillimor, bashkërendues, monitorues e administrativ me strukturat e tjera akademike dhe administrative të universitetit, si dhe ofron ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë.
6. NJSBC-ja harton një raport vjetor në të cilin përfshihen informacione dhe vlerësime për procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar si dhe rekomandon masa për përmirësimin e parametrave të cilësisë. Raporti Vjetor paraqitet fillimisht pranë Komisionit për Vlerësimin Institucional, i cili ja paraqet Senatit Akademik për ta përfshirë më pas në rendin e ditës të mbledhjes së radhës së tij.
7. Kryerja e vlerësimit të brendshëm të strukturave ose programeve të studimit realizohet në mënyrë periodike në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë.
8. NJSBC-ja përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional.
9. NJSBC-ja publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë.
10. Veprimtaria e kësaj njësie rregullohet me rregullore të veçantë që miratohet nga Senati i AU-së.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

### KREU VIII PRONAT DHE ADMINISTRIMI

#### Neni 69

##### Parimet bazë të organizimit financiar

Administrimi dhe organizimi financiar i AU-së udhëhiqet nga parimet bazë:

- a. autonomia financiare;
- b. konkurrenca e lirë;
- c. liria e burimeve ligjore të financimit;
- d. miradministrimi i fondeve/buxhetit;
- e. fryma e bashkëpunimit.

#### Neni 70

##### Organizimi financiar

1. AU-ja si një universitet jopublik është pjesë e shoqërisë tregtare UFO shpk.
2. Organet drejtuese të AU-së bashkëpunojnë ngushtë me shoqërinë për mbarëvajtjen financiare të universitetit, e cila funksionon mbi bazën e planeve buxhetore.
3. Bordi i Administrimit të AU-së miraton një plan buxhetor afatmesëm tre vjeçar dhe një plan buxhetor vjetor për vitin pasardhës kalendarik.
4. Bordi i Administrimit të AU-së miraton raportin e veprimtarisë financiare të AU-së të hartuar nga Administratori i Përgjithshëm, në bashkëpunim me zyrën e financës dhe Rektoratin.

#### Neni 71

##### Pronat në administrim

1. Pronat e paluajtshme në të cilat ushtron veprimtarinë e saj AU-ja, që i shërbejnë për të garantuar përmbushjen e misionit të tij dhe i vihen në përdorim nga shoqëria tregtare janë:
  - a) Godina e ish Estradës, Bulevardi Zogu I, Tiranë;
  - b) ish Hotel Adriatik, Rr. Kavajës, Tiranë;
  - c) ish Hotel Internacional, Rr. Kajo Karafili, Tiranë;
  - d) ish Gjykata, Rr. Durrësit, Tiranë.
2. Bordi i Administrimit në përputhje me nevojat e procesit mësimor, mbi bazën e kërkesës e përcjellë nga Senati Akademik, mund të vendosë të rrisë kapacitetet infrastrukturore.

#### Neni 72

##### Të ardhurat e krijuara nga AU dhe përdorimi i tyre

1. Të ardhurat që krijohen nga AU-ja përbëhen nga:
  - a. të ardhurat nga tarifat e studimeve;
  - b. të ardhura e krijuara nga marrëdhëniet me palë të treta;
  - c. të ardhura nga financimet në kuadrin e projekteve dy e shumëpalëshe;
  - d. të ardhura nga veprimtari kërkimore-shkencore;
  - e. të ardhura nga shërbimeve të tjera të specializuara;





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

- f. të ardhura nga financime të tjera të ligjshme.
2. Të ardhurat e krijuara sipas pikës 1 të këtij neni derdhen në llogarinë e shoqërisë tregtare UFO shpk.
3. Mënyra e përdorimit të tyre përcaktohet në buxhetin vjetor të miratuar nga Bordi i Administrimit.

### Neni 73

#### Tarifat e studimeve

1. Tarifat e studimeve përfshijnë tarifën e shkollimit dhe detyrime të tjera sipas kontratës së studimit.
2. Tarifat e studimeve propozohen nga Senati Akademik dhe miratohen nga Bordi i Administrimit, para fillimit të vitit akademik.

### Neni 74

#### Autonomia financiare

1. AU-ja funksionon sipas parimit të autonomisë financiare.
2. AU-ja harton një plan buxhetor afatmesëm, i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Ky plan përditësohet çdo vit.

### Neni 75

#### Granti i punës kërkimore-shkencore

1. AU-ja ka të drejtë të aplikojë pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit për marrjen e grantit të punës kërkimore-shkencore, ku bëjnë pjesë fondet për kërkimin shkencor.
2. Ky grant bën të mundur edhe sigurimin e fondeve për studimet e doktoratës mbi bazën e aplikimit, nga ku përjashtohet financimi i ngarkesës së pedagogëve për udhëheqjen e doktoratës.

### Neni 76

#### Programi i Ekselencës

1. Për të nxitur veprimtarinë mësimore dhe shkencore të studentëve, krijimin e shembujve, praktikave dhe modeleve të punës së mirë, AU krijon "Programin e Ekselencës".
2. Bordi i Administrimit, çdo vit akademik, miraton kriteret që duhet të përmbush studentit për t'u bërë pjesë e "Programit të Ekselencës". Mbi bazën e këtyre kriterëve, Senati Akademik miraton listën emërore të studentëve që bëhen pjesë e këtij programi.
3. Studentët që janë pjesë e "Programit të Ekselencës" përfitojnë reduktim të tarifës së studimit në masën e përcaktuar në vendimin e Senatit Akademik.

### Neni 77

#### Kategoritë me tarifë të reduktuar

1. Bazuar në politikat për mbështetjen e personave me nevoja të veçanta dhe sociale, AU-ja çdo vit miraton kategoritë e studentëve që do të përfitojnë tarifë të reduktuar.





## STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY

2. Kërkesat e kandidatit për student apo studentit të regjistruar për të përfituar tarifa të reduktuara, mbështeten në evidenca të caktuara, të cilat vërtetojnë statusin e tij.

### Neni 78

#### Kontrolli dhe auditimi

1. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në AU realizohet nga Njësia e Auditit të Brendshëm, e cila funksionon pranë Zyrës të Financës.
2. Njësia e Auditit të Brendshëm është në varësi të Bordit të Administrimit.
3. Fusha e veprimit të kësaj njësie dhe funksionimi i saj bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe parashikohet në Rregulloren e Funksionimit të Zyrës së Financës dhe Auditit të Brendshëm.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore të parashikuara në legjislacionin në fuqi, kontrolli dhe auditimi i jashtëm në AU kryhen nga auditues të jashtëm financiar.





STATUTI I ALBANIAN UNIVERSITY  
KREU IX  
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 79  
Amendimi i Statutit

1. Senati Akademik ka të drejtë të bëjë shtesa dhe ndryshime në këtë Statut sipas së njëjtës procedurë që ndiqet për miratimin e tij.
2. Çdo amendim i këtij Statuti, merr vlerë vetëm pasi miratohet nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Miratuar nga Senati Akademik me vendim Nr 8. Datë 10/05/2023.

Bordi i Administrimit me vendim Nr 7 Datë 10/05/2023

Kryetari i Senatit Akademik  
Rektori  
Prof. Dr. Pavllo Kongo

*Bashkëlidhur këtij Statuti:*

*Aneks 1 - Stema dhe vula e institucionit.*

*Aneks 2 - Organigrama (Struktura Institucionale) e Albanian University.*



48



# ALBANIAN UNIVERSITY

UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

[www.albanianuniversity.edu.al](http://www.albanianuniversity.edu.al)



*Prof. Dr. Lovro Lajç*







# ALBANIAN UNIVERSITY

UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

www.albanianuniversity.edu.al

## SENATI AKADEMIK

Nr. 383 / 11 Prot

Tiranë, më 10.05.2023

Vendim nr. 8

Senati Akademik i "Albanian University" në mbledhjen e tij datë 10.05.2023, bazuar në shkresën me nr. 8431/1 Prot., datë 16.02.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të kuadrit Rregullator në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, administruar pranë "Albanian University" me nr. 90, Prot., datë 20.02.2023, me anë të së cilës janë përcjellë vlerësime në lidhje me Projekt Statutin e depozituar nga "Albanian University", në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe bazuar në Nenin 3 pika 1/d të rregullores "Mbi organizimin dhe funksionimin e Senatit Akademik",

### VENDOSI:

Të miratojë Statutin e përmirësuar të "Albanian University".

Ky Statut i dërgohet Ministrisë Përgjegjëse për Arsimin, për të kryer kontrollin e ligjshmërisë së tij dhe miratimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ngarkohen strukturat përkatëse për zbatimin e tij.

Rektor

Prof. Dr. Pavllo Kongo





# ALBANIAN UNIVERSITY

UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

www.albanianuniversity.edu.al

## BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 381 / Prot  
12

Tiranë, më 10.05.2023

Vendim nr. 7

Bordi i Administrimit të "Albanian University" në mbledhjen e tij datë 10/05/2023, si dhe mbështetur në Ligjin "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë", Nr. 80/2015,

### VENDOSI:

Të miratojë paraprakisht Projekt Statutin e përmirësuar të "Albanian University", të propozuar nga Rektori i "Albanian University" pas ndryshimeve të bëra bazuar në shkresën me nr. prot.8431/1 datë 16.02.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme Rregullore për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të kuadrit Rregullator në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit administruar pranë "Albanian University" me nr.90, Prot, datë 20.02.2023 me anë të së cilës janë përcjellë vlerësime në lidhje me Projekt Statutin e depozituar nga "Albanian University".

Ky Projekt Statut i përcillet Senatit Akademik për miratim përfundimtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ngarkohen strukturat përkatëse për zbatimin e tij.

Kryetar i Bordit të Administrimit  
Dr. Amanda Gjyli

